



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 61/5 Prot.

Vlorë më, 09.01. 2025

VENDIM

Nr. 5, datë 09.01.2025

**PËR
MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E UNIVERSITETIT
"ISMAIL QEMALI", VLORE**

Në mbështetje të nenit 33, 49, pika 1, gërma gj, të Ligjit nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kerkimin shkencor, në institucionet arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" nenit 25 të Statutit të UV-së, si dhe referuar propozimit të Rektorit të UV-së, ardhur me shkresë 2823 prot, datë, 04.12.2024, shkresës nr.3106, prot, datë 24.12.2024, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 09.01.2025,

VENDOSI

1. Të miratojë disa ndryshime në statutin e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Vendimi përcillet për miratim të mëtejshëm në Senatin Akademik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Sotir NIKOLLA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

- Ndryshimin e pikës 4 të nenit 10 (referuar rekomandimeve të raportit të MAS)

Ishte:

Neni 10
Njësitë bazë

4. UV-ja përbëhet nga këto njësi bazë:
- a) Departamenti i Drejtësisë;
 - b) Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë;
 - c) Departamenti i Edukimit;
 - ç) Departamenti i Gjuhëve të Huaja;
 - d) Departamenti i Biznesit;
 - dh) Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit;
 - e) Departamenti i Ekonomiksit;
 - ë) Departamenti i Infermierisë;
 - f) Departamenti i Kujdesit Shëndetësor;
 - g) Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare;
 - gj) Departamenti i Shkencave Detare;
 - h) Departamenti i Fizikës;
 - i) Departamenti i Biologjisë;
 - j) Departamenti i Matematikës;
 - k) Departamenti i Shkencave Kompjuterike;
 - l) Departamenti i Kimisë.

Bëhet:

Neni 10
Njësitë bazë

4. UV-ja përbëhet nga këto njësi bazë:

Fakulteti Shkencave Humane:

- a) Departamenti i Drejtësisë;
- b) Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë;
- c) Departamenti i Edukimit;
- ç) Departamenti i Gjuhëve të Huaja;

Fakulteti i Ekonomisë:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

- a) Departamenti i Biznesit;
- b) Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit;
- c) Departamenti i Ekonomiksit;

Fakulteti i Shëndetit:

- a) Departamenti Infermierisë;
- b) Departamenti i Kujdesit Shëndetësor;
- c) Qendra Kërkimore Shkencore për Shëndetin Publik

Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore:

- a) Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare;
- b) Departamenti i Shkencave Detare;
- c) Departamenti i Biologjisë;
- ç) Departamenti i Matematikës dhe Fizikës;
- d) Departamenti i Shkencave Kompjuterike;
- dh) Departamenti i Kimisë.

- **Shtimin e pikës 3 të nenit 11:** Qendra e kërkimit shkencor nëse do të jetë pjesë e strukturës së njësisë kryesore për plotësimin e standardeve të kësaj njësie, duhet të përbëhet nga të paktën 7 anëtarë, nga të cilët, të paktën 3 të jenë me grada shkencore ose tituj. Drejtuesi zgjidhet sipas rregullave të zgjedhjes së drejtuesit të njësisë bazë.
- **Ndryshimin e Nenit 13 Njësitë ndihmëse:**

Ishte:

1. Strukturat ndihmës-akademike me karakter administrative në nivel institucioni janë:

A. Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore

- a) Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës;
- b) Sektorit i Komunikimit dhe Marrëdhënive me Publikun;
- c) Sektori i IT-së;

B. Sektori Juridik


C. Qendra Studimore Ndërdisciplinore e Zhvillimit Rajonal


D. Drejtoria e Edukimit për Ciklin e I&II

- a) Sektori i Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve;
- b) Sektori i këshillimit të karrierës, Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore-Sportive;

E. Sektori i Biblotekës Shkencor.

F. Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

- a) Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional;
- b) Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

G. Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik

- 2. Këto struktura janë në varësi të Rektorit dhe ndihmojnë në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe /ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë.
- 3. Njësitë ndihmëse me karakter administrativ përbëhen nga personel administrativ dhe janë në varësi të administratorit.

Në varësi të administratorit janë:

A. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

- a) Sektori i Financës dhe Realizimit të Buxhetit;
- b) Sektori i Prokurimeve;
- c) Sektori i Shërbimeve.

Në varësi të Bordit të Administrimit është:

- a) Sektori i Auditit të Brendshëm.

Bëhet:

Struktura Akademike në nivel institucioni

- 1. Senati Akademik
- 2. Rektori
- 3. Rektor
- 4. Zv.Rektori Akademik
- 5. Zv.Rektori për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor


Struktura ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel institucioni

- 1. Sektori i kurrikulave dhe statistikave
- 2. Sektori i kërkimit shkencor dhe projekteve
- 3. Sektori i marrëdhënieve me jashtë
- 4. Sektori i promovimit dhe marrëdhënieve me publikun
- 5. Sektori i karrierës, shërbimit të studentëve dhe alumni
- 6. Sektori i sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe akreditimit
- 7. Sektori i bibliotekës dhe botimeve
- 8. Sektori IT
- 9. Sektori juridik
- 10. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll- Arkivit
- 11. Qendra e Zhvillimit Rajonal
- 12. Asistenti i Rektorit



Struktura Administrative në nivel institucioni

- 1. Bordi i Administrimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

2. Administratori
3. Sektori i Auditimit të brendshëm
4. Sektori ekonomik
5. Sektori i prokurimeve dhe investimeve
6. Sektori i shërbimeve

Struktura Akademike në nivel njësie kryesore

1. Dekanati
2. Dekan
3. Zv.dekan akademik
4. Zv.dekan për kërkimin shkencor

Struktura ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel njësie kryesore

1. Sekretaria mësimore
2. Asistenti i Dekanit / Specialist i Arkiv-Protokollit
3. Sektori i Shërbimeve Ndhmës/akademike
 - a. Biblioteka
 - b. Zyra IT
 - c. Zyra e studentëve

Struktura administrative në nivel njësie kryesore

1. Sektori i Shërbimeve Administrative
 - a. Financë – specialist
 - b. Shërbime: mirëmbajtës, punonjës pastrimi.

Struktura ndihmës akademike me karakter akademik në nivel njësie bazë

1. Laborant

Struktura ndihmës akademike me karakter akademik në nivel Qendre kërkimore/shkencore

1. Specialist
2. Laborant


- Ndryshimin e nenit 17

Ishte :

Neni 17 Senati Akademik

1. Senati është organi kolegjal më i lartë akademik i UV-së, përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

2. Senati kryesohet nga Rektori dhe mbledhet periodikisht, por jo më pak se një herë në muaj.
3. Numri i anëtarëve të Senatit Akademik të UV-së është 23, duke përfshirë dhe Rektorin e UV-së.
4. Anëtarët e Senatit Akademik të UV-së zgjidhen me shumicë votash, nga asamblетë e personelit akademik të njësive kryesore përkatëse, përmes një votimi të përgjithshëm. Ata zgjidhen për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, midis anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë, të vetëkandiduar.
5. Anëtarët e Senatit Akademik i përkasin kategorisë "Profesor" ose kanë gradën shkencore "Doktor" (PhD), të fituar në universitete të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në mungesë të personelit akademik me këtë titull dhe, për efekt të përfaqësimit, kategoria e tyre mund të zbresë dhe të përzgjidhen si anëtarë të senatit edhe personel akademik që mban gradën shkencore "Doktor".
6. Në Senatin Akademik përfaqësohen edhe studentët, në masën dhjetë përqind. Anëtarët e Senatit Akademik, përfaqësues të studentëve zgjidhen nga studentët në përputhje me rregulloren e zgjedhjeve.
7. Senati Akademik zgjedh, në mbledhjen e tij të parë e me propozim të Rektorit, nënkryetarin dhe sekretarin e senatit. Rektori, nënkryetari dhe sekretari përbëjnë kryesinë e Senatit Akademik. Kryesia e Senatit Akademik kujdeset për mbarrëvajtjen dhe funksionimin normal të Senatit Akademik.



Bëhet:

Neni 17 Senati Akademik

1. Senati është organi kolegjal më i lartë akademik i UV-së, përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij.
2. *Anëtarët e Senatit Akademik të Universitetit 'Ismail Qemali' zgjidhen*
Varianti I: me përfaqësim të barabartë në nivel njësie kryesore sipas përbërjes së mëposhtme:
Rektori, 4 Dekanët, 2 anëtarë përfaqësues të studentëve si dhe nga 4 anëtarë për secilin fakultet
Varianti II: me përfaqësim të barabartë në nivel njësie bazë sipas përbërjes së mëposhtme:
Rektori, 4 Dekanët, 2 anëtarë përfaqësues të studentëve si dhe nga një përfaqësues nga secili departament në total 23 anëtarë.

Totali i numrit të anëtarëve të Senatit Akademik është 23: 1 Rektor + 4 Dekanë + 16 staf akademik + 2 studentë.

3. Anëtarët e Senatit Akademik të UV-së zgjidhen me shumicë votash, nga asamblетë e personelit akademik të njësive kryesore përkatëse, përmes një votimi të përgjithshëm. Ata zgjidhen për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, midis anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë, të vetëkandiduar.
4. Anëtarët e Senatit Akademik i përkasin kategorisë "Profesor" ose kanë gradën shkencore "Doktor" (PhD), të fituar në universitete të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

mungesë të personelit akademik me këtë titull dhe, për efekt të përfaqësimit, kategoria e tyre mund të zbresë dhe të përzgjidhen si anëtarë të senatit edhe personel akademik që mban gradën shkencore "Doktor".

5. Anëtarët e Senatit Akademik, përfaqësues të studentëve zgjidhen nga studentët në masën 10 përqind në përputhje me rregulloren e zgjedhjeve.
6. Senati kryesohet nga Rektori dhe mbledhet periodikisht, por jo më pak se një herë në muaj.
7. Senati Akademik zgjedh, në mbledhjen e tij të parë e me propozim të Rektorit, nënkryetarin dhe sekretarin e senatit. Rektori, nënkryetari dhe sekretari përbëjnë Kryesinë e Senatit Akademik. Kryesia e Senatit Akademik kujdeset për mbarrëvajtjen dhe funksionimin normal të Senatit Akademik.

- **Ndryshimin e pikës 1 të nenit 18**

Ishte:

Neni 18

Mbarimi i mandatit të anëtarit të Senatit Akademik

1. Mandati i anëtarit të Senatit Akademik mbaron kur:
 - a) jep dorëheqjen;
 - b) largohet nga UV-ja;
 - c) bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrijë funksionin;
 - ç) nuk merr pjesë për 3 (tri) herë radhazi, pa shkaqe të arsyeshme në mbledhjet e Senatit Akademik;
 - d) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - dh) nuk jeton më.


Bëhet:

Neni 18

Mbarimi i mandatit të anëtarit të Senatit Akademik

1. Mandati i anëtarit të Senatit Akademik mbaron kur:
 - a) me mbarimin e afatit;
 - b) jep dorëheqjen;
 - c) largohet nga UV-ja; kur ndërpret marrëdhëniet e punës me UV-në;
 - ç) bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrijë funksionin;
 - d) nuk merr pjesë për 3 (tri) herë radhazi, pa shkaqe të arsyeshme në mbledhjet e Senatit Akademik;
 - dh) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - e) mbush moshën e pensionit;
 - ë) nuk jeton më.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE


• Ndryshimin e nenit 22

Ishte:

Neni 22

Komisionet e përhershme


1. Komisionet e përhershme janë organe kolegjinale, që kryejnë funksione në fushat e përcaktuara në statut, që lidhen kryesisht me kualifikimin shkencor dhe promovimin akademik, garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, me mbarrëvajtjen e veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikën e institucionit.
2. Komisionet e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme për çdo njësi kryesore (KSBCF):
 - a) Këto komisione përbëhen nga 7 anëtarë nga të cilët 6 janë personel akademik dhe 1 student, që vetëkandidohen dhe zgjidhen respektivisht nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore midis anëtarëve të saj, me përfaqësues nga të gjithë departamentet dhe që kanë së paku gradën shkencore "Doktor i shkencave", si dhe studentët me kohë të plotë të njësisë kryesore për përfaqësuesin e tyre, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
 - b) Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për KSBCF. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të KSBCF-së, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit.
 - c) Funksionet kryesore të këtyre komisioneve lidhen me garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit si në aspektin akademik, dhe në atë administrativ. KSBCF-të i kushtojnë një vëmendje të veçantë procesit mësimor për çdo program studimi, rezultateve akademike të studentëve dhe marrëdhënieve të tyre me personelin akademik, si dhe realizojnë studime gjurmuese lidhur me ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programit të ofruar.
 - ç) Në ushtrim të këtyre funksioneve KSBCF-ja harton rekomandime drejtuar KSBC-së në nivel institucional, autoriteteve apo organeve drejtuese, sipas natyrës së problematikës të konstatuar, mbi parregullsitë e vërejtura së bashku me propozimet përkatëse. Në rast se, pavarësisht këtyre rekomandimeve, situata nuk ndryshon, KSBCF-ja vendos në dijeni sipas rastit Këshillin e Etikës, Senatin Akademik ose Rektorin për marrjen e masave përkatëse.
 - d) Minimalisht në përfundim të çdo sezoni mësimor të vitit akademik, KSBCF-të nxjerrin rekomandime mbi standardet e cilësisë në njësinë kryesore përkatëse.
 - dh) Mënyra e funksionimit të komisionit përcaktohet në rregulloren e brendshme të UV-së.
3. Komisioni i Sigurimit të Cilësisë së Brendshme në nivel institucional (KSBCI):
 - a) Ky komision përbëhet nga 7 anëtarë nga të cilët 6 janë personel akademik dhe 1 student, që vetëkandidohen dhe zgjidhen respektivisht nga SA-ja, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
 - b) Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për KSBCI. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të KSBCI-së, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE


- c) Funksionet kryesore të këtij komisioni lidhen me garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit si në aspektin akademik, dhe në atë administrativ.
 - ç) KSBCI-ja e institucionit i kushton një vëmendje të veçantë procesit mësimor për çdo program studimi, rezultateve akademike të studentëve dhe marrëdhënieve të tyre me personelin akademik, realizon studime gjurmuese lidhur me ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programit të ofruar.
 - d) Në ushtrim të këtyre funksioneve KSBCI-ja e institucionit harton rekomandime drejtuar autoriteteve apo organeve drejtuese, sipas natyrës së problematikës të konstatuar mbi parregullsitë e vërejtura së bashku me propozimet përkatëse. Në rast se, pavarësisht këtyre rekomandimeve, situata nuk ndryshon, KSBCI-ja vendos në dijeni sipas rastit Këshillin e Etikës, Senatin Akademik ose Rektorin për marrjen e masave përkatëse.
 - dh) Minimalisht në përfundim të çdo sezoni mësimor të vitit akademik, KSBCI-ja nxjerr rekomandime mbi standardet e cilësisë në nivel institucional.
 - e) Mënyra e funksionimit të komisionit përcaktohet në rregulloren e brendshme të UV-së.
4. Komisionet e marrëdhënieve me studentët për çdo fakultet (KMSF):
- a) Këto komisione përbëhen nga 7 anëtarë nga të cilët 6 janë personel akademik dhe 1 student, që vetëkandidohen dhe zgjidhen respektivisht nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore midis anëtarëve të saj dhe studentët me kohë të plotë të njësisë kryesore për përfaqësuesin e tyre, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
 - b) Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për KMSF. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të KMSF, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit.
 - c) Funksionet kryesore të këtyre komisioneve lidhen me garantimin e standardeve të marrëdhënieve të fakultetit me studentët. KMSF-të i kushtojnë një vëmendje të veçantë marrëdhënieve të fakultetit me studentët, shërbimeve akademike dhe administrative ndaj tyre, rezultateve akademike dhe marrëdhënieve të tyre me personelin, strukturat, autoritetet/organet drejtuese të fakultetit.
 - ç) Në ushtrim të këtyre funksioneve, KMSF-ja harton rekomandime drejtuar KMSI-së, autoriteteve apo organeve drejtuese, sipas natyrës së problematikës të konstatuar, mbi parregullsitë e vërejtura së bashku me propozimet përkatëse. Në rast se, pavarësisht këtyre rekomandimeve, situata nuk ndryshon, KMSF-ja vendos në dijeni sipas rastit Këshillin e Etikës, Senatin Akademik ose Rektorin për marrjen e masave përkatëse. Minimalisht në përfundim të çdo sezoni mësimor të vitit akademik, KMSF-të nxjerrin rekomandime mbi standardet e cilësisë në njësinë kryesore përkatëse.
5. Komisionet e marrëdhënieve me studentët në nivel institucional (KMSI):
- a) Këto komisione përbëhen nga 7 anëtarë nga të cilët 6 janë personel akademik dhe 1 student, që vetëkandidohen dhe zgjidhen respektivisht nga asambleja e personelit akademik të institucionit midis anëtarëve të saj dhe studentët me kohë të plotë të njësisë kryesore për përfaqësuesin e tyre, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

- b) Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për KMSI. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të KMSI-së, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit.
- c) Funksionet kryesore të këtyre komisioneve lidhen me garantimin e standardeve të marrëdhënies së institucionit me studentët. KMSI-të i kushtojnë një vëmendje të veçantë marrëdhënieve të UV-së me studentët, shërbimeve akademike dhe administrative ndaj tyre, rezultateve akademike dhe marrëdhënieve të tyre me personelin, strukturat, autoritetet/organet drejtuese të institucionit.
- ç) Në ushtrim të këtyre funksioneve KMSI-ja harton rekomandime drejtuar autoriteteve apo organeve drejtuese, sipas natyrës së problematikës të konstatuar, mbi parregullsitë e vërejtura së bashku me propozimet përkatëse. Në rast se, pavarësisht këtyre rekomandimeve, situata nuk ndryshon, KMSF-ja vendos në dijeni, në mënyrë përfundimtare, sipas rastit Këshillin e Etikës, Senatin Akademik ose Rektoren për marrjen e masave përkatëse. Nëse nuk merren masa adekuate, KMSI-të i drejtohen Asamblesë së Personelit Akademik. Minimalisht në përfundim të çdo sezoni mësimor të vitit akademik, KMSI-të nxjerrin rekomandime mbi standardet e cilësisë në njësinë kryesore përkatëse.
- d) Mënyra e funksionimit të komisionit përcaktohet në Rregulloren e brendshme të UV-së.
6. Komisioni i dhënies së gradës shkencore "Doktor" për çdo fakultet (KDGDF):
- a) Komisionet përbëhen nga 7 anëtarë. Asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore përzgjedh nga personeli akademik i njësisë kryesore përkatëse anëtarët e KDGF-së. Ata mbajnë titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar". Anëtarët e këtij komisioni kanë mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për komisionin doktoral. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të komisionit, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit.
- b) Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore që zhvillon një program studimi të ciklit të tretë, e krijon menjëherë këtë komision, ndërsa fakultetet e tjera e krijojnë atë pasi të kenë marrë miratimin përkatës për të zhvilluar këtë nivel programi dhe ciklin studimi.
7. Komisioni i i Promovimit të Personelit Akademik:
- a) Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik përbëhet nga 7 anëtarë. Senati Akademik përzgjedh nga personeli akademik i njësisë kryesore anëtarët e Komisionit të Dhënies së Titujve Akademikë. Ata mbajnë titullin "Profesor" dhe vetëkandidohen. Anëtarët e këtij komisioni kanë mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Bazuar në aktet nënligjore, komisioni me miratimin e SA-së mund të vendosë edhe kritere të tjera, përveç kritereve standarde, sipas fushave të studimit dhe nevojave të universitetit.
- b) Mënyra e funksionimit të komisioneve të përhershme përcaktohet në rregulloren e Universitetit.
- c) Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për Komisionin e Promovimit të Personelit Akademik. Kur nuk ka të tillë, Senati shpall vendin vakant dhe zgjedh anëtarin e ri nga personeli i vetëkandiduar, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË


UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

Bëhet:

Neni 22

Komisionet e përhershme

1. Komisionet e përhershme janë organe kolegjiale, të krijuara në nivel institucional dhe në nivel të njësisë kryesore, që kryejnë funksione në fushat e përcaktuara në statut, që lidhen kryesisht me kualifikimin shkencor dhe promovimin akademik, garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, si dhe me mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikat e institucionit.
2. Në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë ngrihen dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre këto Komisione të Përhershme:
 - a. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni (KSBCI);
 - b. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për çdo njësi kryesore (KSBCF);
 - c. Komisioni për studentët, alumnin dhe këshillimin e karrierës në nivel institucional (KSAKKI)
 - d. Komisioni për studentët, alumnin dhe këshillimin e karrierës në nivel njësie kryesore (KSAKKF)
 - e. Komisioni i dhënies së gradës shkencore "Doktor" për çdo njësi kryesore (KDGDf);
 - f. Komisioni i promovimit të personelit akademik.
3. Komisionet e përhershme në nivel institucional në UV janë:
 - a) Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni (KSBCI). Ky komision përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 4 (katër) janë anëtarë nga personeli akademik i UV-së që i përkasin kategorisë "Profesor" ose/dhe "Lektor" dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve.
 - b) Komisioni për studentët, alumnin dhe këshillimin e karrierës në nivel institucional (KSAKKI). Ky komision përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 4 (katër) janë anëtarë nga personeli akademik i UV-së që i përkasin kategorisë "Profesor" ose/dhe "Lektor" dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve.
 - c) Komisioni i promovimit të personelit akademik. Ky komision përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë personel akademik i UV-së, që mbajnë titullin "Profesor".
4. Anëtarët e komisioneve të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një mandate 2 (dy vjeçar), me të drejtë rizgjedhje.
5. Anëtarët e komisioneve të përhershme në nivel njësie kryesore në UV janë:
 - a) Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për çdo njësi kryesore (KSBCF). Ky komision përbëhet nga nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 4 (katër) janë anëtarë nga personeli akademik i njësisë kryesore që i përkasin kategorisë "Profesor" ose/ dhe "Lektor" dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

- b) Komisioni i dhënies së gradës shkencore "Doktor" për çdo njësi kryesore (KDGDF); ky komision përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë nga personeli akademik i njësive kryesore që i përkasin kategorisë "Profesor" ose "Profesor i Asociuar". Anëtarët e këtij komisioni kanë mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
 - c) Komisioni për studentët, alumnin dhe këshillimin e karrierës në nivel njësie kryesore (KSAKKF) Ky komision përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 4 (katër) janë anëtarë nga personeli akademik i njësive kryesore që i përkasin kategorisë "Profesor" ose/ dhe "Lektor" dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve.
 - 6. Anëtarët e komisioneve të përcaktuara në pikën 5 të këtij neni vetëkandidohen dhe zgjidhen nga asambleja e personelit akademik të njësive kryesore midis anëtarëve të saj, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
- **Ndryshimin e pikës 1, gërma m, p të nenit Neni 25 Funkcionet e Bordit të Administrimit në zbatim të shkresës nr. 1079/3 prot, datë 12.05.202, shkresës nr.4350/1 prot, datë 09.09.2021 të MAS**

Ishte:

- m) përcakton dhe miraton masën e shpërblimit të anëtarëve të Bordit të Administrimit, Senatit Akademik si dhe sekretarëve respektivë;
- p) përcakton dhe miraton masën e shpërblimit të anëtarëve të komisioneve të përhershme;

Bëhet:

- m) përcakton dhe miraton masën e shpërblimit të anëtarëve të Bordit të Administrimit, Senatit Akademik .
- p) shfuqizohet; pasi është e njëjtë me gërmën n të po këtij neni.


- **Saktësim të pikës 1 gërma f) të nenit 26 Rektorati si dhe shtim të pikës 4 dhe 5**

Ishte:

**Neni 26
Rektorati**

1. Rektorati në institucionet e arsimit të lartë është organ kolegjal që drejtohet nga Rektori dhe përbëhet nga:
 - a) rektori;
 - b) zëvendësrektori/ët;
 - c) administratori i institucionit;
 - ç) drejtuesit e njësive kryesore.
2. Rektorati në mbledhjet e tij mund të ftojë edhe personel tjetër në varësi të natyrës specifike të çështjes së shtruar për diskutim.
3. Rektorati ka këto funksione kryesore:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË


UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE


- a) harton dhe paraqet në Senatin Akademik projekt-planin e zhvillimit strategjik të institucionit;
- b) formulon kriteret për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore;
- c) përcakton përparësitë në plotësimin e kërkesave të njësive të institucionit për financime, mbi të cilat do të hartohet projekt-buxheti vjetor;
- ç) propozon rekomandime në SA për programet e studimit dhe kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
- d) propozon rekomandime në SA për strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit për të gjitha nivelet;
- dh) propozon në SA për miratim planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore shkencore;
- e) propozon në SA për miratim raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit;
- ë) paraqet rekomandime në SA mbi projekt-marrëveshjet, bashkëpunimet apo anëtarësimet e institucionit në organizma apo institucione kombëtare ose ndërkombëtare;
- f) merr masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të Senatit Akademik;
- g) harton dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit;
- gj) propozon në SA Kodin e Etikës.

Bëhet:

Neni 26 Rektorati

1. Rektorati në institucionet e arsimit të lartë është organ kolegjal që drejtohet nga Rektori dhe përbëhet nga:
 - a) rektori;
 - b) zëvendësrektori/ët;
 - c) administratori i institucionit;
 - ç) drejtuesit e njësive kryesore.
2. Rektorati në mbledhjet e tij mund të ftojë edhe personel tjetër në varësi të natyrës specifike të çështjes së shtruar për diskutim.
3. Rektorati ka këto funksione kryesore:
 - a) harton dhe paraqet në Senatin Akademik projekt-planin e zhvillimit strategjik të institucionit;
 - b) formulon kriteret për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore;
 - c) përcakton përparësitë në plotësimin e kërkesave të njësive të institucionit për financime, mbi të cilat do të hartohet projekt-buxheti vjetor;
 - ç) propozon rekomandime në SA për programet e studimit dhe kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
 - d) propozon rekomandime në SA për strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit për të gjitha nivelet;
 - dh) propozon në SA për miratim planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore shkencore;
 - e) propozon në SA për miratim raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

- ë) paraqet rekomandime në SA mbi projekt-marrëveshjet, bashkëpunimet apo anëtarësimet e institucionit në organizma apo institucione kombëtare ose ndërkombëtare;
 - f) merr masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të Senatit Akademik që i ngarkohen këtij organi;
 - g) harton dhe paraqet për miratim rregulloren e UV-së;
 - gj) propozon në SA Kodin e Etikës.
4. Mbledhja e Rektoratit thirret nga Rektori ose të paktën një e treta e anëtarëve të tij. Për çdo mbledhje të Rektoratit mbahet procesverbal. Rektorati shprehet me vendime dhe udhëzime për çështjet që merren në shqyrtim.
5. Rektorati harton rregulloren e funksionimit të tij, e cila miratohet nga Senati Akademik.

- Në nenin 27 shtohet pika 2, 3, 5 dhe 6

Ishte:

Neni 27 Dekanati

1. Dekanati në institucionet e arsimit të lartë është organ kolegjal që drejtohet nga dekani dhe përbëhet nga:

- a) dekani;
- b) zëvendësdekanët;
- c) administratori i njësisë kryesore;
- ç) drejtuesit e njësive bazë.

2. Dekanati ka këto funksione kryesore:

- a) koordinon veprimtarinë e njësive bazë të fakultetit;
- b) diskuton dhe propozon në rektorat masa për zhvillimin dhe funksionimin e njësisë kryesore;
- c) diskuton paraprakisht probleme që lidhen me programet e studimit, kriteret e pranimit në këto programe, shpërndarjen e financimeve dhe përparësitë e zhvillimit të fakultetit;
- ç) diskuton dhe paraqet në Senatin Akademik projektplanin e zhvillimit strategjik të të njësisë kryesore mbi bazën e propozimeve të njësive bazë;
- d) përcakton dhe propozon në rektorat përparësitë në plotësimin e kërkesave të njësive të njësive bazë për financime, mbi të cilat do të hartohet projektbuxheti vjetor;
- dh) paraqet rekomandime në rektorat dhe SA mbi programet e studimit dhe kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre, sipas propozimeve të njësive bazë;
- e) paraqet në rektorat për miratim planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore shkencore të njësisë kryesore, sipas propozimeve të njësive bazë;
- ë) paraqet në rektorat për miratim raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së fakultetit, mbështetur në raportet e hartuara nga njësitë bazë;
- f) merr masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të Senatit Akademik, Rektoratit, Rektorit dhe zëvendësrektorëve;
- g) harton dhe miraton paraprakisht rregulloren e brendshme të funksionimit të fakultetit, dhe çdo lloj rregulloreje tjetër, përpara miratimit perfundimtar nga SA;





VLORE
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE


- gj) jep lejet etike për të kryer kërkim/mbledhur të dhëna për punimet dhe projektet kërkimore shkencore;
- h) kompetenca më të detajuara përcaktohen në rregulloren e Universitetit.

Bëhet:

Neni 27 Dekanati

1. Dekanati në institucionet e arsimit të lartë është organ kolegjal që drejtohet nga dekani dhe përbëhet nga:
 - a) dekani;
 - b) zëvendësdekanët;
 - c) administratori i njësisë kryesore;
 - ç) drejtuesit e njësive bazë.
2. Në mbledhjen e dekanatit mund të thirren edhe persona të tjerë sipas nevojës.
3. Mënyra e thirrjes, e funksionimit dhe e organizimit të dekanatit zhvillohet në përputhje me rregulloren e fakultetit.
4. Dekanati ka këto funksione kryesore:
 - a) koordinon veprimtarinë e njësive bazë të fakultetit;
 - b) diskuton dhe propozon në rektorat masa për zhvillimin dhe funksionimin e njësisë kryesore;
 - c) diskuton paraprakisht probleme që lidhen me programet e studimit, kriteret e pranimit në këto programe, shpërndarjen e financimeve dhe përparësitë e zhvillimit të fakultetit;
 - ç) diskuton dhe paraqet në Senatin Akademik projek-tplanin e zhvillimit strategjik të njësisë kryesore mbi bazën e propozimeve të njësive bazë;
 - d) përcakton dhe propozon në rektorat përparësitë në plotësimin e kërkesave të njësive të njësive bazë për financime, mbi të cilat do të hartohet projektbuxheti vjetor;
 - dh) paraqet rekomandime në rektorat dhe SA mbi programet e studimit dhe kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre, sipas propozimeve të njësive bazë;
 - e) paraqet në rektorat për miratim planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore shkencore të njësisë kryesore, sipas propozimeve të njësive bazë;
 - ë) paraqet në rektorat për miratim raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së fakultetit, mbështetur në raportet e hartuara nga njësitë bazë;
 - f) merr masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të Senatit Akademik, Rektoratit, Rektorit dhe zëvendësrektorëve;
 - g) harton dhe miraton paraprakisht rregulloren e brendshme të funksionimit të fakultetit dhe çdo lloj rregulloreje tjetër, përpara miratimit perfundimtar nga SA;
 - gj) jep lejet etike për të kryer kërkim/mbledhur të dhëna për punimet dhe projektet kërkimore shkencore;
 - h) kompetenca më të detajuara përcaktohen në rregulloren e Universitetit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

5. Dekanati mbledhet periodikisht dhe për çdo mbledhje mbahet procesverbal i cili duhet të zbardhet të firmoset nga gjithë anëtarët e Dekanatit prezent në mbledhje.
6. Dekanati shprehet me vendime dhe udhëzime për çështjet që merren në shqyrtim. Dekanati ushtron funksione të tjera të parashikuara në këtë Statut dhe akte të tjera të Universitetit.

• Saktësimin e nenit 28 Këshilli i Etikës

Ishte :


Neni 28 Këshilli i Etikës

1. Këshilli i Etikës i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë promovon dhe shqyrton çështje, që lidhen me etikën në veprimtarinë e institucionit, në fushën akademike dhe në atë kërkimore-shkencore.
2. Këshilli i Etikës përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, katër prej të cilëve personel akademik me kohë të plotë, nga një për çdo fakultet, që mbajnë të paktën gradën shkencore "Doktor", një përfaqësues nga radhët e personelit ndihmës akademik, një nga personeli administrativ dhe një përfaqësues nga radhët e studentëve. Kandidati për anëtar vetëkandidohet dhe zgjidhet nga Senati Akademik, me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve dhe votim të fshehtë. Çdo njësi kryesore nuk mund të përfaqësohet me më shumë se një anëtar në Këshillin e Etikës. Mandati i anëtarit të Këshillit të Etikës është pesëvjeçar.
3. Nuk mund të zgjidhet anëtar në Këshillin e Etikës personeli akademik i emëruar në funksione drejtuese.
4. Këshilli i Etikës vihet në lëvizje përmes ankesave. Vendimmarrja kryhet me shumicë të cilësuar prej katër të pestave.
5. Këshilli i Etikës, në bashkëpunim me Rektoratin, përgatit dhe i propozon Senatit Akademik, Kodin e Etikës së Universitetit.
6. Këshilli i Etikës në rastin e shqyrtimit të çështjeve që lidhen me etikën në veprimtarinë e universitetit shprehet me vendim dhe i propozon Rektorit marrjen e masës disiplinore. Vendimi i Këshillit të Etikës është i ankimueshëm në Gjykatë.

Bëhet:

Neni 28 Këshilli i Etikës

1. Këshilli i Etikës i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë promovon dhe shqyrton çështje, që lidhen me etikën në veprimtarinë e institucionit, në fushën akademike dhe në atë kërkimore-shkencore, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale sipas parashikimeve të Kodit të Etikës dhe legjislacionit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë.
2. Këshilli i Etikës është organ kolegjal, i cili përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, katër prej të cilëve personel akademik me kohë të plotë, nga një për çdo fakultet, që mbajnë të paktën gradën shkencore "Doktor", një përfaqësues nga radhët e personelit ndihmës akademik,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

një nga personeli administrativ dhe një përfaqësues nga radhët e studentëve. Kandidati për anëtar vetëkandidohet dhe zgjidhet nga Senati Akademik, me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve dhe votim të fshehtë. Çdo njësi kryesore nuk mund të përfaqësohet me më shumë se një anëtar në Këshillin e Etikës. Mandati i anëtarit të Këshillit të Etikës është pesëvjeçar me të drejtë rizgjedhje.


3. Nuk mund të zgjidhet anëtar në Këshillin e Etikës personeli akademik i emëruar në funksione drejtuese.
4. Këshilli i Etikës vihet në lëvizje përmes ankesave. Vendimarrja kryhet me shumicë të cilësuar prej katër të pestave.
5. Këshilli i Etikës, në bashkëpunim me Rektoratin, përgatit dhe i propozon Senatit Akademik, Kodin e Etikës së Universitetit. Projekt-kodi i përgatitur nga Këshilli i Etikës, përpra se të dërgohet për miratim në Senatin Akademik duhet të kalojë për konsultim në të gjitha njësitë kryesore si dhe zyrën juridike të UV-së.
6. Këshilli i Etikës në rastin e shqyrtimit të çështjeve që lidhen me etikën në veprimtarinë e universitetit shprehet me vendim dhe i propozon Rektorit marrjen e masës disiplinore. Vendimi i Këshillit të Etikës është i ankimeshëm në Gjykatë.

• Në nenin 30 janë shtuar pika 4 dhe 5

4. Rektori zgjidhet nga anëtarët e asambleve të personelit akademik të njërive kryesore dhe studentët. Votat e studentëve në përzgjedhjen e rektorit llogariten në masën dhjetë për qind të totalit të përgjithshëm të votave. Kandidatët për rektor vetëkandidohen dhe duhet të kenë përvojë në mësimdhënie ose kërkim shkencor jo më pak se 10 (dhjetë) vjet;
5. Kandidatët për rektor duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a. Nuk kanë qenë në ndjekje penale dhe ndaj tyre nuk është dhënë një masë e sigurimit personal;
 - b. Të kenë përvojë akademike dhe administrative
 - c. Të mos jenë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - c. Të mos kenë masë disiplinore në fuqi
 - dh. Të mos kenë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 45/2015 ("Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë") dhe ligjit nr. 138/2015 ("Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike");
 - e. Të mos kenë qenë rektorë të zgjedhur për dy ose më shumë mandate, të njëpasnjëshme ose të ndara në të njëjtin institucion ku do të kandidojnë. Në numrin e mandateve, sipas kësaj pike, llogariten mandatet e fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim, të fituara me zgjedhje, pavarësisht kohëzgjatjes.
 - ë. Kriteret e tjera të vendosura në Rregulloren e zgjedhjeve të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

- Në nenin 31, në të cilin parashikohen funksionet e Rektorit të bëhen ndryshimet si më poshtë, referuar Rekomandimeve të MAS:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

- Neni 31, pika 26:

Ishte:

Urdhëron ngritjen e komisioneve ad hoc për konkursin e punësimit të personelit akademik, të personelit ndihmësakademik me karakter mësimor, të personelit ndihmësakademik me karakter administrativ, si dhe të personelit administrativ, sipas përcaktimeve në këtë Statut.

Bëhet:

Urdhëron ngritjen e komisioneve ad hoc për konkursin e punësimit të personelit akademik, dhe personelit ndihmësakademik, sipas përcaktimeve në këtë Statut.

- Neni 31, pika 27:

Ishte:

Trajton ankesat e subjekteve të interesuara lidhur me procedurat e zhvillimit të konkurimit dhe vendimeve të komisioneve ad-hoc për rekrutimin e personelit akademik, të personelit ndihmësakademik me karakter mësimor, të personelit ndihmësakademik me karakter administrativ, si dhe të personelit administrativ sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në ligjin nr. 44/ 2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" dhe në këtë Statut.


Bëhet:


Trajton ankesat e subjekteve të interesuara lidhur me procedurat e zhvillimit të konkurimit dhe vendimeve të komisioneve *ad-hoc* për rekrutimin e personelit akademik dhe të personelit ndihmësakademik, sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në ligjin nr. 44/ 2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" dhe në këtë Statut.

- Neni 31, pika 29:

Ishte:

Në përfundim të procesit të ankimimit administrativ, kur vlerëson se ankimi është i pranueshëm, me cilësinë e organit epëror, vendos me një akt të ri anulimi, shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit të komisionit *ad-hoc* për rekrutimin e personelit akademik, të personelit ndihmës akademik me karakter mësimor, të personelit ndihmësakademik me karakter administrativ, si dhe të personelit administrativ,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

Bëhet:

Në përfundim të procesit të ankimimit administrativ, kur vlerëson se ankimi është i pranueshëm, me cilësinë e organit epëror, vendos me një akt të ri anulimin, shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit të komisionit *ad-hoc* për rekrutimin e personelit akademik dhe personelit ndihmësakademik.

- Neni 31, pika 30:

Ishte:

Miraton klasifikimin përfundimtar të konkursit të punësimit të personelit akademik (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme) dhe të personelit ndihmësakademik me karakter mësimor, të personelit ndihmësakademik me karakter administrativ, si dhe të personelit administrativ dhe emëron kandidatin/ kandidatët e shpallur fitues (me përjashtim të administratorit të UV-së, administratorëve të njësive kryesore dhe të njësive bazë).

Bëhet:

Miraton klasifikimin përfundimtar të konkursit të punësimit të personelit akademik (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme) dhe të personelit ndihmësakademik.

Emëron kandidatin/ kandidatët e shpallur fitues.

- Neni 31, pika 39:

Ishte:

Ushtron të drejtën e dhënies së masave disiplinore ndaj personelit akademik ndihmësakademik dhe administrativ.


Bëhet:

Ushtron të drejtën e dhënies së masave disiplinore ndaj personelit akademik dhe personelit ndihmësakademik.

- Neni 31, pika 42:

Ishte:

Urdhëron, pas propozimit të Administratorit ose konstatimit kryesisht, largimin nga detyra dhe zgjidhjen e marrdhënies së punës me personelin administrativ të UV-së, (me përjashtim të administratorëve të njësive kryesore dhe njësive bazë), sipas parashikimeve të ligjit nr. 7961, datë 12. 07. 1995 "Kodi i Punës të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

Bëhet:

Kjo pikë shfuqizohet.

- Neni 31, pika 43:

Ishte:

Urdhëron zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës me personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ të UV-së, sipas parashikimeve të ligjit nr. 7961, datë 12. 07. 1995 "Kodin i Punës të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Bëhet:

Urdhëron zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës me personelin akademik, ndihmësakademik, sipas parashikimeve të ligjit nr. 7961, datë 12. 07. 1995 "Kodin i Punës të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

- Saktësim të pikës 2 neni 32

Ishte:

2.Zëvendësrektorët i përkasin kategorisë "Profesor" ose kanë gradën shkencore "Doktor" ("PhD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Ata janë anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë, të cilët emërohen dhe shkarkohen nga Rektori pas miratimit në Senatin Akademik.

Bëhet:

2.Zëvendësrektorët i përkasin kategorisë "Profesor" ose kanë gradën shkencore "Doktor" ("PhD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Ata janë anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë, të cilët emërohen dhe shkarkohen nga Rektori pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej tij në Senatin Akademik

- Ndryshimin e nenit 34

Ishte:

Neni 34

Drejtuesi i njësisë kryesore

1. Drejtuesi i njësisë kryesore në UV ushtron këto funksione:

- a) përfaqëson njësinë kryesore në organet e UV-së dhe në marrëdhënie me të tretët për çështjet akademike dhe protokollare;






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

- b) drejton dekanatin dhe raporton para tij;
 - c) drejton dhe kontrollon veprimtarinë e strukturave të njësive kryesore për çështjet akademike dhe protokollare;
 - ç) garanton zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, të statutit dhe të rregulloreve të UV-së në njësinë kryesore;
 - d) i përcjell Senatit Akademik propozimet e njësive bazë, shoqëruar me mendimet e tij;
 - dh) i përcjell rektorit propozimet e njësive bazë, shoqëruar me mendimet e tij;
 - e) i paraqet Rektorit kërkesat e njësive kryesore me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;
 - ë) emëron drejtues të njësive bazë kandidat fitues në zgjedhje;
 - f) emëron drejtuesin e njësive bazë në rastet e krijimit të një njësie bazë të re dhe ia përcjell rektorit;
 - g) emëron titullarët e grupeve mësimore e kërkimore;
 - gj) emëron dhe shkarkon zëvendësdekanin;
 - h) i propozon rektorit shkarkimin e autoritetit drejtues të njësive bazë në institucionet publike të arsimit të lartë në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së institucionit të arsimit të lartë. Rektori shprehet brenda një muaji. Zëvendësuesi i drejtuesit të njësive bazë caktohet nga rektori, me propozimin e drejtuesit të njësive kryesore;
 - i) i propozon rektorit largimin nga detyra dhe zgjidhjen e marrëdhënies së punës me personelin ndihmës akademik të njësive kryesore, sipas parashikimeve të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
 - j) i propozon rektorit zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës me personelin akademik dhe ndihmës akademik të njësive kryesore, sipas parashikimeve të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
 - k) miraton komisionin, që do të realizojë procedurat për njohjen dhe njësimin e periudhave të studimit për të gjitha rastet e përcaktuara në ligj dhe aktet e tjera nënligjore (rifillim studimesh, transferim studimesh etj.);
 - l) harton planin kalendarik;
 - ll) i përcjell organeve dhe autoriteteve drejtuese të UV-së të gjitha aktet që dalin nga njësia bazë dhe njësia kryesore që drejton, të shoqëruara me mendimet e tij;
 - m) miraton propozimin e njësive bazë për përbërjen e komisioneve të provimeve të formimit, të mbrojtjes së diplomave;
 - n) nënshkruan diplomat dhe certifikatat e përfundimit të studimeve pa të drejtë të delegimit të firmës;
 - nj) marrëdhëniet e drejtuesit të njësive kryesore me organet e tjera, mënyra dhe kushtet e ushtrimit të kompetencave të tij, parashikohen në Rregulloren e UV-së.
 - o) i propozon administratorit të institucionit shkarkimin e administratorit të njësive kryesore.
2. Drejtuesi i njësive kryesore në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me urdhëra, udhëzime dhe akte të tjera sipas legjislacionit në fuqi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË


UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE


Bëhet:

Neni 34

Drejtuesi i njësisë kryesore

1. Drejtuesi i njësisë kryesore është dekani i fakultetit. Ai drejton asamblenë e personelit akademik të njësisë kryesore.
2. Dekani është autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore dhe përfaqësuesi i saj. Ai koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve kolegjiale të njësisë kryesore so dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre.
3. Dekani zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore dhe studentët. Votat e studentëve në përzgjedhjen e drejtuesit llogariten në masën dhjetë për qind të totalit të përgjithshëm të votave. Kandidati për drejtues vetëkandidohet. Ai është personel akademik i kategorisë "Profesor" dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë ose dhe jashtë tij.
4. Kandidatët për dekan duhet:
 - a) të kenë përvojë në mësimdhënie ose kërkim shkencor jo më pak se 10 vjet;
 - b) të kenë përvojë akademike në cilësinë e titullarit të disiplinave të lëndëve, si dhe të kenë zhvilluar kurrikula, programe lëndësh, të kenë përgatitur literaturë mbështetëse dhe/ose të kenë zhvilluar projekte kërkimore etj., prej të paktën 5 vitesh;
 - c) të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
 - ç) të mos jenë dënuar më parë me një vendim të formës së prerë për vepra penale;
 - d) të mos ketë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" dhe ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
5. Mandati i drejtuesit zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit, ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.
6. Rektori i Universitetit emëron drejtues të njësisë kryesore kandidatin fitues, të dalë nga zgjedhjet.
7. Kur vendi i Dekanit mbetet i lirë, si pasojë e përfundimit të parakohshëm të mandatit për arsyet e paracaktuara në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në Statut, Rektori komandon në detyrë një nga zëvendësdekanët.
8. Drejtuesi i njësisë kryesore në UV ushtron këto funksione:
 - a) përfaqëson njësinë kryesore në organet e UV-së dhe në marrëdhënie me të tretët për çështjet akademike dhe protokollare;
 - b) drejton dekanatin dhe raporton para tij;
 - c) drejton dhe kontrollon veprimtarinë e strukturave të njësisë kryesore për çështjet akademike dhe protokollare;
 - ç) garanton zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, të statutit dhe të rregulloreve të UV-së në njësinë kryesore;
 - d) i përcjell Senatit Akademik propozimet e njësive bazë, shoqëruar me mendimet e tij;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË


UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE


- dh) i përcjell rektorit propozimet e njësive bazë, shoqëruar me mendimet e tij;
 - e) i paraqet Rektorit kërkesat e njësisë kryesore me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;
 - ë) emëron drejtues të njësisë bazë kandidatit fitues në zgjedhje;
 - f) emëron drejtuesin e njësisë bazë në rastet e krijimit të një njësie bazë të re dhe ia përcjell rektorit;
 - g) emëron titullarët e grupeve mësimore e kërkimore;
 - gj) emëron dhe shkarkon zëvendësdekanin;
 - h) i propozon rektorit shkarkimin e autoritetit drejtues të njësisë bazë në institucionet publike të arsimit të lartë në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së institucionit të arsimit të lartë. Rektori shprehet brenda një muaji. Zëvendësuesi i drejtuesit të njësisë bazë caktohet nga rektori, me propozimin e drejtuesit të njësisë kryesore;
 - i) i propozon rektorit largimin nga detyra dhe zgjidhjen e marrëdhënies së punës me personelin ndihmës akademik të njësisë kryesore, sipas parashikimeve të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
 - j) i propozon rektorit zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës me personelin akademik dhe ndihmës akademik të njësisë kryesore, sipas parashikimeve të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
 - k) miraton komisionin, që do të realizojë procedurat për njohjen dhe njësimin e periudhave të studimit për të gjitha rastet e përcaktuara në ligj dhe aktet e tjera nënligjore (rifillim studimesh, transferim studimesh etj.);
 - l) harton planin kalendarik;
 - ll) i përcjell organeve dhe autoriteteve drejtuese të UV-së të gjitha aktet që dalin nga njësia bazë dhe njësia kryesore që drejton, të shoqëruara me mendimet e tij;
 - m) miraton propozimin e njësisë bazë për përbërjen e komisioneve të provimeve të formimit, të mbrojtjes së diplomave;
 - nj) nënshkruan diplomat dhe certifikatat e përfundimit të studimeve pa të drejtë të delegimit të firmës;
 - n) marrëdhëniet e drejtuesit të njësisë kryesore me organet e tjera, mënyra dhe kushtet e ushtrimit të kompetencave të tij, parashikohen në Rregulloren e UV-së.
 - o) i propozon administratorit të institucionit shkarkimin e administratorit të njësisë kryesore.
9. Drejtuesi i njësisë kryesore në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me urdhëra, udhëzime dhe akte të tjera sipas legjislacionit në fuqi.

• Saktësimin e nenit 36

Ishte:

Neni 36
Zëvendësdekani





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

1. Zëvendësdekanët janë anëtarë me kohë të plotë të personelit akademik dhe kanë së paku gradën shkencore "Doktor".
2. Numri i zëvendësdekanëve, emërimi dhe shkarkimi i tyre përcaktohet nga vetë Dekani me vendim sipas nevojave të njësisë kryesore. Numri i zëvendësdekanëve nuk mund të jetë më shumë se dy.
3. Kompetencat e zëvendësdekanëve përcatohen sipas Rregullores.

Bëhet:

Neni 36 Zëvendësdekani


1. Dekani, në ushtrimin e funksioneve të tij, ndihmohet nga zëvendësdekanët
2. Zëvendësdekanët janë anëtarë me kohë të plotë të personelit akademik dhe kanë së paku gradën shkencore "Doktor".
3. Numri i zëvendësdekanëve, emërimi dhe shkarkimi i tyre përcaktohet nga vetë Dekani me vendim sipas nevojave të njësisë kryesore. Numri i zëvendësdekanëve nuk mund të jetë më shumë se dy.
4. Kompetencat e zëvendësdekanëve përcatohen në Rregulloren e Brendshme të UV-së.

- Saktësimin e nenit 38 pika 1 shtohet si mëposhte:

Neni 38 Drejtuesi i njësisë bazë

1. Drejtuesi i njësisë bazë është drejtuesi i departamentit ose i qendrës kërkimore-shkencore. Ai është autoriteti drejtues akademik i asaj njësie dhe e përfaqëson atë. Në institucionet publike të arsimit të lartë ai zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë bazë. Ai zgjidhet nga personeli akademik sipas përcaktimeve ligjore dhe duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
 - a) duhet të jetë personel akademik i kategorisë "Profesor" ose të ketë gradën shkencore "Doktor" PhD të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të BE-së ose të OECD-së;
 - b) duhet të ketë përvojë në mësimdhënie për një periudhë jo më pak se 5 vjet dhe të jetë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë;
 - c) të ketë veprimtari të spikatur akademike, kërkimore e shkencore të vazhdueshme
 - ç) të mos jetë dënuar me një vendim të formës së prerë për vepra penale;
 - d) të mos ketë masë disiplinore në fuqi; e) të mos ketë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" dhe ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose nshirojnë funksione publike".





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

- Saktësimin e nenit 40 sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë si dhe Rekomandimeve të MAS

1. Neni 40, pika 3 shkronja e:

Ishte:

I propozon Bordit të Administrimit kriteret specifike të punësimit të personelit administrativ, si dhe marrjen e masave disiplinore;

Bëhet:

Në cilësinë e punëdhënësit të personelit administrativ i propozon Bordit të Administrimit kriteret dhe procedurat e punësimit si dhe ushtron të drejtën e dhënies së masave disiplinore ndaj personelit administrativ.

Neni 40, pika 3 shkronja ë:

Ishte:

Propozon komisionin *ad-hoc* për konkursin e rekrutimit të personelit administrativ, sipas përcaktimeve në këtë Statut;

Bëhet:

Urdhëron ngritjen e komisionit *ad-hoc* për konkursin e rekrutimit të personelit administrativ, sipas përcaktimeve në këtë Statut;


2. Në nenin 40 pika 3 të shtohen si vijon:


- **gërma h)** Pas përfundimit të afateve ligjore emëron dhe nënshkruan kontratën e punës me personelin administrativ të UV- së.
- **gërma i)** Urdhëron largimin nga detyra dhe zgjidhjen e menjëhershme të marrdhënies së punës me personelin administrativ të UV-së sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

- Shtimin e nenit Neni 44 Personeli akademik, pika 4, 5, 6, 7

Ishte:

**Neni 44
Personeli akademik**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE


1. Personeli akademik në UV kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të UV-së, këshillim për studentët, konsulencë e trajnime për të tretët, si dhe veprimtari të tjera.
1. Personeli akademik në UV është me orientim mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor. Njësitë bazë dhe kryesore kanë detyrimin që të bëjnë këtë klasifikim për UV-në dhe ta rinovojnë atë në mënyrë periodike.
2. Personeli akademik në UV, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në:
 - a) profesorë;
 - b) lektorë;
 - c) asistent-lektorë.
3. Në kategorinë "Profesorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë "Profesor" ose "Profesor i asociuar".


Bëhet

Neni 44

Personeli akademik

1. Personeli akademik në UV kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të UV-së, këshillim për studentët, konsulencë e trajnime për të tretët, si dhe veprimtari të tjera.
2. Personeli akademik në UV është me orientim mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor. Njësitë bazë dhe kryesore kanë detyrimin që të bëjnë këtë klasifikim për UV-në dhe ta rinovojnë atë në mënyrë periodike.
3. Personeli akademik në UV, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në:
 - a) profesorë;
 - b) lektorë;
 - c) asistent-lektorë.
4. Në kategorinë "Profesorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë "Profesor" ose "Profesor i asociuar". Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.
5. Në kategorinë "Lektorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik, që zhvillojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore. Në këtë kategori përfshihen anëtarët e personelit akademik, që mbajnë gradën shkencore "Doktor", kanë së paku tre vite eksperiencë në mësimdhënie para ose pas fitimit të kësaj grade shkencore. Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.
6. Në kategorinë "Asistent-lektorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore-kërkimore. Asistent-lektorët duhet të kenë së paku diplomën "Master i shkencave". Asistent-lektori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të caktuar.
7. Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Ngarkesa e plotë mësimore për personelin akademik përcaktohet nga





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

strukturat përgjegjëse në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin.

- **Saktësim të pikës 9, 10, 13 të nenit 45 (pasi udhëzimet mund te ndryshohen here pas here)**

Ishte:

9. Koha normale e punës së personelit akademik nuk mund të jetë më shumë se 1 536 orë në vit. Ngarkesa mësimore e personelit akademik parashikohet në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin.

10. Leja vjetore e personelit akademik është jo më pak se 40 ditë pune (56 ditë kalendarike). Në rast se kjo leje nuk konsumohet nga personeli akademik, si pasojë e nevojës së institucionit dhe me propozimin e përgjegjësit të njësisë bazë dhe me miratimin e Bordit të Administrimit, jepet shpërblimi përkatës në të holla.

13. Personeli akademik mund të kryejë detyra të larta në administratën publike, vendase apo të huaj, për jo më shumë se 5 vjet, pa ndërprerje, duke ruajtur statusin e tij. Në funksion të ruajtjes së vendit të punës, sipas profilit akademik, nënshkruhet një marrëveshje e posaçme me rektorin e UV-së. Pas kësaj periudhe, anëtari i personelit akademik, me kërkesën e tij, rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend të barasvlefshëm.


Bëhet:


9. Koha normale e punës së personelit akademik si dhe ngarkesa mësimore parashikohet në përputhje me aktet nenligjore ose udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin.

10. Leja vjetore e personelit akademik përcaktohet në aktet nenligjore ose udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Në rast se kjo leje nuk konsumohet nga personeli akademik, si pasojë e nevojës së institucionit dhe me propozimin e përgjegjësit të njësisë bazë dhe me miratimin e Bordit të Administrimit, jepet shpërblimi përkatës në të holla.

13. Personeli akademik mund të kryejë detyra të larta në administratën publike, vendase apo të huaj, për jo më shumë se 5 vjet, pa ndërprerje, duke ruajtur statusin e tij. Në funksion të ruajtjes së vendit të punës, sipas profilit akademik, nënshkruhet një marrëveshje e posaçme me rektorin e UV-së. Pas kësaj periudhe, anëtari i personelit akademik, me kërkesën e tij, rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend të barasvlefshëm. Në rastet kur detyra në administratën publike ka zgjatur më shumë se 5 (pesë) vjet pa ndërprerje, personeli akademik e humb statusin e tij.

- **Shtohet në Nenin 47 pika 3:** Numri maksimal i personelit akademik të ftuar përcaktohet përfundimisht me vendim Rektorati, jo më i lartë se numri total i miratuar paraprakisht nga Bordi i Administrimit.
- **Ndryshim Neni 48 per vitin sabatik**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

Ishte:

Neni 48

Viti akademik sabatik

1. Personeli akademik i kategorisë "Lektor" dhe "Profesor", me miratim të njësisë bazë ku zhvillon veprimtarinë akademike, ka të drejtë të shkëputet nga angazhimet e institucionit, një herë në shtatë vjet, për periudha kohe deri në një vit, për të punuar për përparimin e tij akademik.
2. Midis personelit akademik dhe rektorit të Universitetit "Ismail Qemali" nënshkruhet një kontratë ku rregullohen kohëzgjatja, të drejtat dhe detyrimet, si dhe efektet financiare.
3. Gjatë kësaj periudhe, personelit akademik nuk i ngarkohet detyrë mësimdhënieje.
4. Personeli akademik mund të ndjekë gjatë këtij viti kurse specializimi jashtë institucionit.


Bëhet:

Neni 48

Viti akademik sabatik

1. Personeli akademik i kategorisë "Lektor" dhe "Profesor", me miratim të njësisë bazë ku zhvillon veprimtarinë akademike, ka të drejtë të shkëputet nga angazhimet e institucionit, një herë në shtatë vjet, për periudha kohe deri në një vit, për të punuar për përparimin e tij akademik.
2. Për të përfutur nga parashikimi i pikës 1, anëtari personelit akademik duhet të paraqesë në departament kërkesën e tij të shoqëruar me propozimin përkatës për kërkimin shkencor që do të realizojë, vendin ku do ta ushtrojë këtë kërkim, nëse ka, kohën e nevojshme që i duhet, si edhe produktin që do të dorëzojë në fund të kësaj periudhe. Departamenti shpreh miratimin e tij dhe njofton drejtuesin e njësisë kryesore dhe Rektorin e UT-së.
3. Nëse kërkohet edhe mbështetje financiare në përputhje me zërat buxhetorë të miratuar nga Bordi i Administrimit për këtë qëllim, propozimi i kalon edhe Bordit të Administrimit për miratimin e pjesës financiare.
4. Kërkesa, në çdo rast duhet që të paraqitet dy muaj përpara fillimit të vitit akademik sabatik.
5. Gjatë vitit akademik sabatik, anëtari i personelit akademik paguhet me 100 për qind të pagës.
6. Midis personelit akademik dhe rektorit të Universitetit "Ismail Qemali" nënshkruhet një kontratë ku rregullohen kohëzgjatja, të drejtat dhe detyrimet, si dhe efektet financiare.
7. Gjatë kësaj periudhe, personelit akademik nuk i ngarkohet detyrë mësimdhënieje.
8. Personeli akademik mund të ndjekë gjatë këtij viti kurse specializimi jashtë institucionit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

9. Mosrealizimi i kërkimit shkencor, sipas programit të miratuar, përbën shkak për përgjegjësi disiplinore, si dhe detyron të rimbursojë të gjitha përfimet financiare që ka marrë.
10. Mënyra e kontrollit të cilësisë së produktit që duhet të realizohet gjatë vitit sabbatik, bëhet në përputhje me parashikimet e rregullores së njësisë kryesore, sipas marrëveshjes së nënshkruar.

• Neni 49 Personeli ndihmësakademik ishte:

Personeli ndihmësakademik në UV ndahet në personel ndihmësakademik me karakter mësimor dhe ndihmësakademik me karakter administrativ.

1. Strukturat ndihmësakademike me karakter administrative në nivel institucioni janë:

- a) Strukturat e kurrikulave;
- b) Strukturat e kërkimit shkencor;
- c) Strukturat e projekteve;
- ç) Strukturat e promovimit akademik dhe botimeve;
- d) Strukturat e marrëdhënieve me publikun;
- dh) Strukturat e marrëdhënieve me jashtë;
- e) Strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë;
- ë) Strukturat e karrierës;
- f) Strukturat e bibliotekave;
- g) Strukturat juridike;
- gj) Strukturat e teknologjisë së informacionit;
- h) Strukturat e burimeve njerëzore;
- i) Strukturat e arkiv-protokollit;
- j) Asistent i rektorit.

2. Strukturat ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel njësie kryesore janë:

- a) Sekretaritë mësimore të njësive kryesore;
- b) Asistent i dekanit.

3. Strukturat ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel njësie bazë janë:

- a) Sekretaritë në Departamentet e Drejtësisë dhe Gjuhëve të Huaja (pasi përmbushin kriterin e pikës 10 të udhëzimit nr 27, datë 29.12.2017).


4. Personeli i strukturave sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni janë personel ndihmësakademik me karakter administrativ në kuptim të pikës 3 të nenit 66 të ligjit 80/2015.

5. Strukturat ndihmësakademike me karakter mësimor në nivel njësie kryesore dhe bazë janë:

- b) laborantët;
- c) specialistët e QKSH-ve.

6. Personeli i strukturave sipas pikës 5 të këtij neni konsiderohen personel ndihmësakademik me karakter mësimor në kuptim të pikës 2 të nenit 66 të ligjit 80/2015.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

Bëhet: Neni 53 Personeli ndihmëeakademik si më poshtë:


Neni 53 Personeli ndihmësakademik


1. Personeli ndihmësakademik në UV ndahet në personel ndihmësakademik me karakter mësimor dhe ndihmësakademik me karakter administrativ.
2. Personeli ndihmësakademik me karakter mësimor është pjesë e njësisë bazë. Ai ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor. Në këtë kategori futen laborantët, teknikët si dhe personel tjetër, sipas përcaktimeve të bëra në aktet ligjore e nënligjore. Struktura përcaktohet në rregulloren e institucionit.
3. Personeli ndihmësakademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe /ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel institucional. Në këtë kategori bëjnë pjesë personeli i përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore. Struktura përcaktohet në rregulloren e institucionit.

- **Nenet që flasin për kategoritë e personelit kanë ndryshur duke u vendosur sipas renditjes që ka ligji si dhe duke shtuar procedurat e punësimit të cilat mungonin duke u shtuar nenet si më poshtë:**

Neni 49 Punësimi i personeli akademik me kohë të plotë

1. Punësimi i personelit akademik dhe ndihmësakademik në UV bëhet me konkurs në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë, përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit, miratohen nga rektori dhe publikohen në faqen eeb të UV-së.
3. Rektori krijon komisionin *ad hoc* për rekrutimin e personelit akademik me kohë të plotë me shumicë nga njësia bazë. Komisioni *ad-hoc* përbëhet nga pesë anëtarë: 3 përfaqësues nga departamenti që kërkon të punësojë, 1 përfaqësues i dekanit dhe 1 përfaqësues i rektorit/punëdhënësit.
4. Komisioni *ad hoc* vlerëson dhe rendit kandidatët konkurues sipas pikëzimit të vendosur në rregulloren, e UV-së dhe ia përcjell rektorit i cili vendos në mënyrë përfundimtare mbi secilën kandidaturë.
5. Ankesat në lidhje me vlerësimin e kandidatëve dhe zbatimin e procedurave nga komisioni *ad hoc*, paraqiten tek rektori brenda 5 (pesë) ditëve. Kandidati i lind e drejta e ankimit nga e nesërmja e njoftimit për fazën e parë të vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar. Në këtë rast, rektori urdhëron komisionin *ad-hoc* për pezullimin e procedurës së konkursit deri në përfundimin e procedurës së shqyrtimit të ankimit. Kur vlerëson se ankimi është i pranueshëm, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të ankimit, rektori vendos me një akt të ri anulimin, shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit të komisionit *ad-hoc*. Vendimi i rektorit i njoftohet komisionit *ad-hoc* i cili në vijim cakton datën dhe njofton





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

kandidatët fitues për zhvillimin e intervistës me gojë. Kundër vendimit të fazës së dytë për vlerësimin e intervistës, kandidati ka të drejtën e ankimit brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmbja e njoftimit të këtij vendimi. Në këtë rast, rektori urdhëron shqyrtimin e ankimit. Kur vlerëson se ankimi është i pranueshëm, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga e nesërmbja e njoftimit të ankimit, rektori vendos me një akt të ri anulimin, shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit të komisionit *ad-hoc*.

6. Vendimi përfundimtar i Rektorit për miratimin e klasifikimit përfundimtar dhe shpalljen e fituesit, i njoftohet palëve të interesuara.
7. Rektori emëron kandidatin fitues dhe nënshkruan kontratën e punës.
8. Modalitetet e tjera të punësimit përcaktohen në rregulloren e UV-së.

Neni 50


Punësimi i personelit akademik me kohë të pjesshme


1. Njësitë kryesore, me propozim të njërive bazë, përcaktojnë në bazë të nevojave të tyre kërkesën për personel akademik me kohë të pjesshme. Ky propozim mund të realizohet vetëm nëse ngarkesa mësimore nuk plotësohet me personelin akademik me kohë të plotë. Rektori, në varësi të kërkesave dhe fondit të miratuar për këtë qëllim, miraton çdo vit listën emërore të personelit akademik me kontratë të pjesshme.
2. Ky personel duhet të përmbushë kriteret dhe kërkesat për punësimin me kohë të plotë. Rregullat më të hollësishme mbi mënyrën e konkurimit për personelin akademik me kontratë me kohë të pjesshme përcaktohen në rregulloren e brendshme të UV-së.

Neni 51

Kohëzgjatja e punësimit të personelit akademik

1. Personeli akademik, që mban titullin "Profesor", shërben në detyrë deri në moshën 68 vjeç, me përjashtim të rastit kur, me kërkesën e tij, largohet nga detyra. Mbështetur mbi nevojat e institucionit të arsimit të lartë dhe me pëlqimin e tij, ai mund të shërbejë në detyrë edhe pas moshës së lartpërmendur, përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit, të përsëritshme. Drejtuesi i njësisë bazë ku ai kryen veprimtarinë e tij, me miratimin edhe të drejtuesit të njësisë kryesore, i drejton rektorit propozimin për të mbajtur në detyrë personelin e sipërpërmendur, duke argumentuar dhe nevojën e njësisë bazë në këtë drejtim.
2. Personeli akademik, që mban titullin "Profesor i asociuar", shërben në detyrë deri në moshën 65 vjeç. Mbështetur mbi nevojat e institucionit të arsimit të lartë dhe me pëlqimin e tij, ai mund të shërbejë në detyrë edhe pas moshës së lartpërmendur, përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit, të përsëritshme. Drejtuesi i njësisë bazë ku ai kryen veprimtarinë e tij, me miratimin edhe të drejtuesit të njësisë kryesore, i drejton rektorit propozimin për të mbajtur në detyrë personelin e sipërpërmendur, duke argumentuar dhe nevojën e njësisë bazë në këtë drejtim.
3. Personeli akademik i kategorisë "Profesor" mund të shkëputet përkohësisht nga institucioni i arsimit të lartë, për një periudhë maksimale prej pesë vjetësh, për t'u angazhuar në detyra të rëndësishme shtetërore dhe politike. Për periudhën e shkëputjes mund të zëvendësohet nga





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

personel akademik i punësuar me kontratë me afat të caktuar. Pas përfundimit të detyrës, me kërkesë të tij, anëtar i personelit akademik rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend të barasvlershëm.

Neni 52

Fitimi i titujve akademikë

1. Për fitimin e titullit "Profesor i asociuar" mund të aplikojë personeli akademik që gëzon gradën shkencore "Doktor", prej së paku pesë vitesh, është personel akademik i kategorisë "Lektor" dhe përmbush standardet shtetërore për fitimin e titullit. Për fitimin e titullit "Profesor" mund të aplikojë personeli akademik që gëzon prej së paku pesë vjetësh titullin "Profesor i asociuar", si dhe përmbush standardet shtetërore për fitimin e titullit.
2. Personeli akademik i institucioneve të arsimit të lartë, të cilat nuk përmbushin kriteret për dhënien e titujve akademikë, si dhe personat, të cilët nuk janë personel akademik pranë ndonjë institucioni, por përmbushin standardet për fitimin e titujve, paraqesin kërkesën pranë një institucioni, i cili përmbush kriteret për dhënien e titujve.
3. Kandidati për fitimin e titullit "Profesor i asociuar" ose "Profesor" paraqet dosjen pranë drejtuesit të njësisë kryesore. Dosja e kandidatit i përcillet senatit akademik, pas paraqitjes dhe vlerësimit në njësinë bazë. Senati i kalon dosjen Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, i cili merr vendimin përfundimtar pas vendimit të jurisë mbi përmbushjen e standardeve. Titulli regjistrohet në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin. Titulli akademik lëshohet nga institucioni dhe firmoset nga rektori.
4. Në rast vlerësimi negativ të kërkesës për fitimin e titujve akademikë nga Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, kandidatit i lind e drejta të ripërsërisë kërkesën pas një periudhe kohore jo më të shkurtër se dy vjet.
5. Personelit akademik, që mban titullin "Profesor", pas daljes në pension, në vlerësim të veprimtarisë së spikatur akademike, me propozim të njësisë bazë ku ka zhvilluar karrierën e tij dhe me vendim të Senatit Akademik, i akordohet titulli "Profesor emeritus".


- Shtohet neni 54 për Kategoritë e personelit ndihmësakademik

Neni 54

Kategoritë e personelit ndihmësakademik

1. Personeli ndihmësakademik ndahet në personel ndihmësakademik me karakter mësimor-shkencor dhe ndihmësakademik me karakter administrativ.
2. Personeli ndihmësakademik me karakter mësimor-shkencor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ ose të kërkimit shkencor. Ai është pjesë e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit. Në këtë kategori hyjnë laborantët dhe teknikët, si dhe personel tjetër, sipas përcaktimeve të bëra në aktet e brendshme të institucionit.
3. Personeli ndihmësakademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të zhvillimit të institucionit të arsimit të





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

Iartë në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel institucional. Në këtë kategori bëjnë pjesë personeli i punësuar në strukturat ndihmësakademike pranë Rektoratit, pranë njësive kryesore dhe njësive bazë (pash. Sekretari i departamentit) sipas përcaktimeve të këtij statuti dhe rregullores së Brendshme të UV-së.

- **Shtohet punësimi i personelit ndihmës akademik neni 55 pasi ishte parashikuar bashke me nenin e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë si më poshtë vijon:**

Neni 55

Punësimi i personelit ndihmësakademik

1. Punësimi i personelit ndihmësakademik në UV bëhet me konkurs publik.
2. Punësimi do të realizohet sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në Rregulloren e UV-së.
3. Komisioni *ad hoc* vlerëson dhe rendit kandidatët konkurues sipas pikëzimit të vendosur në Rregulloren e UV-së.
4. Komisioni *ad hoc* i propozon për miratim rektorit renditjen përfundimtare,
5. Ankesat në lidhje me vlerësimin e kandidatëve dhe zbatimin e procedurave nga komisioni *ad hoc*, paraqiten brenda 5 (pesë) ditëve te rektori. Në rast të konstatimit të parregullsive në zbatimin e procedurave, rektori vendos për pavlefshmërinë e procesit dhe ripërsëritjen e tij.
6. Rektori miraton klasifikimin përfundimtar dhe shpall fituesin e procedurës.
7. Rektori emëron kandidatin fitues dhe nënshkruan kontratën e punës.
8. Modalitete e tjera të punësimit përcaktohen në rregullore e brendshme të UV-së.

- **Neni 52 pershtatet me ndryshimet e reja dhe behet neni 57:**

Ishte:

Neni 52


Procedura e punësimit të personelit administrativ

1. Punësimi i personelit administrativ në UV bëhet me konkurs publik.
2. Kriteret dhe procedurat e punësimit të personelit administrativ propozohen nga administratori, miratohen nga Bordi i Administrimit dhe publikohen në faqen ëeb të UV-së.
3. Procedura të mëtejshme përcaktohen në Rregulloren e UV-së.

Bëhet:

Neni 57

Punësimi i personelit administrativ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

1. Kategoritë e personelit administrativ dhe nivelete pagave miratohet nga Bordi i Administrimit konform akteve ligjore në fuqi.
2. Punësimi i personelit administrativ në UV bëhet me konkurs publik.
3. Punësimi do të realizohet sipas kriterëve dhe procedurave të propozuara nga administratori dhe të miratuara nga Bordi i Administrimit të UV-së.
4. Në përfundim të procedurave të punësimit, kontrata e punësimit do të nënshkruhet nga Administratori i institucionit.
5. Modalitete e tjera të punësimit të personelit administrativ përcaktohen në rregullore e brendshme të UV-së.

- Në neni 56 Ciklet e programeve të studimit pika 3 është bashkuar me pikën 2 duke u bërë neni 61 pika 2 Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë ofron diploma profesionale referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programet e studimeve hartohen nga njësitë bazë dhe i kalojnë për miratim Senatit Akademik.
- Është shtuar neni Programet e studimit në fushën e mësuesisë dhe drejtësisë i cili përmban numrin rendor 71:

Neni 71


Programet e studimit në fushën e mësuesisë dhe drejtësisë


1. Programet e studimit në fushën e mësuesisë për arsim parashkollor dhe arsim fillor, organizohen në dy cikle: program i ciklit të parë "Bachelor", që formon mësues të arsimit parashkollor dhe program i ciklit të dytë "Master profesional", që formon mësues të arsimit fillor.
2. Programet e studimit për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", me 120 kredite, sipas fushave përkatëse të formimit.
3. Programet e ciklit të dytë të studimit në fushën e mësuesisë duhet të përmbajnë 25 % të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik.
4. Programet e ciklit të dytë të studimit, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 % të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.
5. Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë të studimeve në fushën e drejtësisë realizohen me 300 kredite, për një kohëzgjatje prej jo më pak se 5 vite akademike.

- Neni 68 Vlerësimi bëhet neni 74 dhe bëhet ndryshimi në pikën 1:

Ishte:

1. Në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10. Nota më e ulët për kalim është 5 (pesë). Në listën e notave që shoqërojnë diplomën pasqyrohen vetëm notat përfundimtare kaluese më e madhe ose e barabartë me 5 (pesë).





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

Bëhet :

1.Në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash: 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10. Nota më e ulët për kalim është 5 (pesë). Në listën e notave që shoqërojnë diplomën pasqyrohen vetëm notat përfundimtare kaluese më e madhe ose e barabartë me 5 (pesë).

Në pikën 3 shtohet gërma d: 10.00, *maxima cum laude*.

Në pikën 7 shtohet togfjalëshi ceremonia e diplomimit zhvillohet për të gjithë fakultetet.

- **Neni 69 Transferimi i studimeve, njohja dhe njësimi i periudhave të studimit është neni 75 duke shtuar pikën 4.** Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet, me qëllim vazhdimin e studimeve në një program studimi të UV-së, merret nga komisioni përkatës, i ngritur nga njësia bazë pranuese.
- **Neni 65 bëhet Neni 71 Lëshimi i diplomave, certifikatave dhe suplementi i diplomës, pika 4 ndryshon si më poshtë:**

Ishte:

Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë. Ai përshkruan, në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit. Modeli i suplementit të diplomës i bashkëlidhet këtij statuti.

Bëhet:

Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë. Ai përshkruan, në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit. Forma dhe specifikat e suplementit të diplomës përcaktohet në rregulloren e UV-së, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë përgjegjëse për Arsimin.

- **Neni 63 bëhet neni 79 Të drejtat dhe detyrimet e studentëve dhe shtohet pika 3** Studentit përsëritës, përgjithësisht, i ndërpritet mbështetja nga fondet publike, me përjashtim të rasteve të forcave madhore.
- **Neni 74 bëhet neni 80 Këshillat e studentëve dhe Shtesë në pikën 5:** Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucioneve të arsimit të lartë, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.
- **Neni 75 Mbrojtësi i Studentëve shfuqizohet**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI

Nr. 3106 / Prot.

Vlorë më, 24.12.2024

Lënda: Përcjellje e bazës ligjore për ndryshimet e disa prej neneve të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

**BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI",
VLORE, Z. SOTIR NIKOLLA**

KËTU


Në zbatim të nenit 33 të ligji nr. 80/2015 për "Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë dhe nga shqyrtimi i akteve të brendshme rregullatore të Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, bashkangjitu po Ju dërgoj:

1. Relacionin e Sektorit Jurid " Mbi ndryshimet e disa prej neneve të Statutit të Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.
2. Shkresën e MAS me Nr.4506/6 datë 25.09.2024 "Dërgohet raporti"
3. Shkresën e MAS me Nr. 4350/1 Prot, datë 09.09.2021 për "Kthim përgjigje"
4. Vendimin e Senatit Akademik Nr.33, datë 05.07.2021 për "Miratimin e disa ndryshimeve në Statutin e Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë"
5. Statutin aktual të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë të miratuar me Urdhër MAS me Nr.197, datë 01.04.2019.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

REKTORI

PROF. DR. Aurela Sallaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1168 / Prot. 2

Vlorë, më 12. 07. 2021

VENDIM

Nr. 33, datë 05. 07. 2021

PËR
MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E UNIVERSITETIT "ISMAIL
QEMALI", VLORE

Në mbështetje të nenit 33, pika 2, nenit 38, pika 1, shkronja c, të Ligjit Nr. 80/2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", në nenin 19, pika 1, gërma c, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Senati Akademik në mbledhjen e datës 05. 07. 2021

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në Statutin e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë si më poshtë:

I- Në nenin 31, në të cilin parashikohen funksionet e Rektorit të bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Neni 31, pika 26:

Ishte:

Urdhëron ngritjen e komisioneve *ad-hoc* për konkursin e punësimit të personelit akademik, të personelit ndihmësakademik me karakter mësimor, të personelit ndihmësakademik me karakter administrativ, si dhe të personelit administrativ, sipas përcaktimeve në këtë Statut.

Bëhet:

Urdhëron ngritjen e komisioneve *ad-hoc* për konkursin e punësimit të personelit akademik, dhe personelit ndihmësakademik, sipas përcaktimeve në këtë Statut.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

2. Neni 31, pika 27:

Ishte:

Trajton ankesat e subjekteve të interesuara lidhur me procedurat e zhvillimit të konkurimit dhe vendimeve të komisioneve *ad-hoc* për rekrutimin e personelit akademik, të personelit ndihmës akademik me karakter mësimor, të personelit ndihmës akademik me karakter administrativ, si dhe të personelit administrativ sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në ligjin nr. 44/ 2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" dhe në këtë Statut.

Bëhet:

Trajton ankesat e subjekteve të interesuara lidhur me procedurat e zhvillimit të konkurimit dhe vendimeve të komisioneve *ad-hoc* për rekrutimin e personelit akademik dhe të personelit ndihmës akademik, sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në ligjin nr. 44/ 2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" dhe në këtë Statut.

3. Neni 31, pika 29:

Ishte:

Në përfundim të procesit të ankimit administrativ, kur vlerëson se ankimi është i pranueshëm, me cilësinë e organit epëror, vendos me një akt të ri anulimi, shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit të komisionit *ad-hoc* për rekrutimin e personelit akademik, të personelit ndihmës akademik me karakter mësimor, të personelit ndihmës akademik me karakter administrativ, si dhe të personelit administrativ,


Bëhet:

Në përfundim të procesit të ankimit administrativ, kur vlerëson se ankimi është i pranueshëm, me cilësinë e organit epëror, vendos me një akt të ri anulimin, shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit të komisionit *ad-hoc* për rekrutimin e personelit akademik dhe personelit ndihmës akademik.

4. Neni 31, pika 30:

Ishte:

Miraton klasifikimin përfundimtar të konkursit të punësimit të personelit akademik (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme) dhe të personelit ndihmës akademik me karakter mësimor, të personelit ndihmës akademik me karakter administrativ, si dhe të personelit administrativ dhe emëron kandidatin/ kandidatët e shpallur fitues (me përjashtim të administratorit të UV-së, administratorëve të njëjësive kryesore dhe të njëjësive bazë).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Bëhet:

Miraton klasifikimin përfundimtar të konkursit të punësimit të personelit akademik (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme) dhe të personelit ndihmësakademik.

Emëron kandidatin/ kandidatët e shpallur fitues (me përjashtim të administratorit të UV-së, administratorëve të njësive kryesore dhe të njësive bazë).

5. Neni 31, pika 39:

Ishte:

Ushtron të drejtën e dhënies së masave disiplinore ndaj personelit akademik ndihmësakademik dhe administrativ.

Bëhet:

Ushtron të drejtën e dhënies së masave disiplinore ndaj personelit akademik dhe personelit ndihmësakademik.

6. Neni 31, pika 42:

Ishte:

Urdhëron, pas propozimit të Administratorit ose konstatimit kryesisht, largimin nga detyra dhe zgjidhjen e marrëdhënies së punës me personelin administrativ të UV-së, (me përjashtim të administratorëve të njësive kryesore dhe njësive bazë), sipas parashikimeve të ligjit nr. 7961, datë 12. 07. 1995 "Kodi i Punës të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Bëhet:

Kjo pikë shfuqizohet.


7. Neni 31, pika 43:

Ishte:

Urdhëron zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës me personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ të UV-së, sipas parashikimeve të ligjit nr. 7961, datë 12. 07. 1995 "Kodin i Punës të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Bëhet:

Urdhëron zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës me personelin akademik, ndihmësakademik, sipas parashikimeve të ligjit nr. 7961, datë 12. 07. 1995 "Kodin i Punës të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

II- Në nenin 40, në të cilin janë parashikuar funksionet e Administratorit të bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Neni 40, pika 3 shkronja e:

Ishte:

I propozon Bordit të Administrimit kriteret specifike të punësimit të personelit administrativ, si dhe marrjen e masave disiplinore;

Bëhet:

Në cilësinë e punëdhënësit të personelit administrativ i propozon Bordit të Administrimit kriteret dhe procedurat e punësimit si dhe ushtron të drejtën e dhënies së masave disiplinore ndaj personelit administrativ.

Neni 40, pika 3 shkronja ë:

Ishte:

Propozon komisionin *ad-hoc* për konkursin e rekrutimit të personelit administrativ, sipas përcaktimeve në këtë Statut;

Bëhet:

Urdhëron ngritjen e komisionit *ad-hoc* për konkursin e rekrutimit të personelit administrativ, sipas përcaktimeve në këtë Statut;

2. Në nenin 40 pika 3 të shtohen si vijon:

- gërma h) Pas përfundimit të afateve ligjore emëron dhe nënshkruan kontratën e punës me personelin administrativ të UV- së.
- gërma i) Urdhëron largimin nga detyra dhe zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës me personelin administrativ të UV-së sipas parashikimeve të legjisllacionit në fuqi.

3. Neni 25, pika 1, shkronja p shfuqizohet.

4. Neni 22 "Komisionet e përhershme" ndryshohet si më poshtë:

1. Komisionet e përhershme janë organe kolegjinale, të krijuara në nivel institucional dhe në nivel të njëjësive kryesore, që kryejnë funksione në fushat e përcaktuara në statut, që lidhen kryesisht



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

me kualifikimin shkencor dhe promovimin akademik, garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, si dhe me mbarrëvajtjen e veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikat e institucionit.

2. Në Universitetin "Ismael Qemali" Vlorë ngrihen dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre këto Komisione të Përhershme:

- Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni (KSBCI);
- Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për çdo njësi kryesore (KSBCF);
- Komisioni për studentët, alumnin dhe këshillimin e karrierës në nivel institucional (KSAKKI)
- Komisioni i dhënies së gradës shkencore "Doktor" për çdo njësi kryesore (KDGDF);
- Komisioni i promovimit të personelit akademik.

2.1 Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni (KSBCI):

- KSBCI është struktura përgjegjëse për garantimin e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë në nivele institucioni si në aspektin akademik dhe në atë administrativ. Ky komision përbëhet nga 7 anëtarë nga të cilët 4 janë personel akademik, 1 personel ndihmës akademik, 1 personel administrativ dhe 1 student. Në përbërje të këtij komisioni zgjidhen të paktën nga një përfaqësues personel akademik për çdo njësi kryesore. Anëtarët e këtij komisioni vetëkandidohen dhe zgjidhen respektivisht nga SA-ja, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Kryetari i komisionit zgjidhet nga anëtarët e KSBCI me shumicë votash të të gjithë anëtarëve në mbledhjen e parë të tyre.
- Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për KSBCI. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të KSBCI-së, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit.
- Anëtarët e Komisioneve duhet të plotësojnë këto kritere:
 - përfaqësuesit e personelit akademik duhet:
 - të zotërojnë së paku gradën shkencore "Doktor"
 - të kenë përvojë pune si anëtarë të personelit akademik për një periudhë së paku pesëvjeçare me kohë të plotë;
 - të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
 - të kenë eksperiencë në hartimin e raportit të vetëvlersimit edhe/ose në procesin e akreditimit;
 - përfaqësues të studentëve, duhet të jetë student me mesatare të përgjithshme mbi 8.0.
 - përfaqësuesit e personelit ndihmës akademik dhe administrativ duhet:
 - të kenë përvojë pune si anëtarë të personelit akademik për një periudhë së paku pesëvjeçare me kohë të plotë;
 - të mos kenë masë disiplinore në fuqi;




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

- të kenë eksperiencë në hartimin e raportit të vetëvlerësimit edhe/ose në procesin e akreditimit.

- d) Funkcionet e këtij komisioni lidhen me garantimin e standardeve shtetërore të cilësisë, si dhe në Standartet dhe Udhëzimet Europiane për Sigurimin e cilësisë (HEAL). Komisioni ushtron kryesisht këto funksione:
- i. Mbështet organet dhe autoritetet drejtuese në hartimin e politikave për sigurimin e brendshëm të cilësisë sipas standarteve dhe legjislacionin në fuqi dhe i dërgon për miratim në Senatin Akademik;
 - ii. Harton Rregulloren e Sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UV dhe e dërgon për miratim në Senatin Akademik;
 - iii. Në bashkëpunim me autoritetet dhe strukturat e UV-së implementon Rregulloren e Sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UV;
 - iv. Pas hartimit të raportit të vlerësimit të cilësisë për lëndët e ofruara në UV nga NJSBC, miraton atë paraprakisht dhe e përçell në Senatin Akademik për miratim të mëtejshëm;
 - v. Vlerëson në mënyrë periodike përmbushjen e standardeve shtetërore të cilësisë në nivel institucioni si dhe raporton përpara Senatit Akademik për rezultatet e vlerësimit;
 - vi. Harton propozime në lidhje me përmirësimin e standardeve të sigurimit të cilësisë dhe i dërgon për miratim në Senatin Akademik;
 - vii. Ofron rekomandime për përmirësimin e procedurave në sigurimin e cilësisë në nivel Institucional;
 - viii. Asiston grupin e vlerësimit të brendshëm (GVB) dhe jep vlerësimin paraprak për raportin e vetëvlerësimit në kuadër të akreditimit institucional;
 - ix. Propozon pranë SA-së planin e veprimit në përmbushje të rekomandimeve të Bordit të Akreditimit për akreditimin institucional, si dhe monitoron zbatimin e tij;
 - x. Vlerëson periodikisht instrumentat egzistues si dhe propozon përdorimin e instrumenta të reja për vlerësimin tërësor të UV-së;
 - xi. Bashkëpunon me struktura të tjera në nivel institucioni si dhe bashëkpuntorë të jashtëm për organizimin e aktiviteteve në përmbushje të standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë;
 - xii. Brenda muajit shtator të çdo viti kalendarik, harton dhe publikon raportin vjetor të veprimtarisë së tij me gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve akademike dhe administrative;
 - xiii. Krijon dhe ruan database me evidencat përkatëse në bazë të standarteve ekzistuese për hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm të Institucionit;
 - xiv. Harton rregulloren e vet si dhe planin e punës;
 - xv. Kryen çdo funksion tjetër të ngarkuar nga autoritetet dhe organet drejtuese të UV-s në fushën e sigurimit të cilësisë.




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

- e) Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj KSBCI mbështetet dhe bashkërendon punën me strukturat/organet e tjera në nivel njësie kryesore/nivel institucioni të ngritura me qëllim sigurimin e brendshëm të cilësisë.

2.2 Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për çdo njësi kryesore (KSBCF):

- a. Funksionet e këtij komisioni lidhen me garantimin e standardeve për sigurimin e cilësisë të programeve të studimit në çdo njësi kryesore. KSBCF përbëhet nga 5 anëtarë në Fakultetin e Shëndetit (FSH) dhe Fakultetin e Ekonomisë (FE) dhe nga 7 anëtarë në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore (FSHTN) dhe Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë (FSHHD) nga të cilët 3 (pranë FSHTN-së dhe FE-së) dhe 5 (pranë FSHTN-së dhe FSHHD-së) respektivisht janë personel akademik, 1 personel ndihmës akademik dhe 1 student. Anëtarët e këtij komisioni vetëkandidohen dhe zgjidhen respektivisht nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore midis anëtarëve të saj, si dhe studentët me kohë të plotë të njësisë kryesore për përfaqësuesin e tyre, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Kryetari i komisionit zgjidhet nga anëtarët e KSBCF me shumicë votash të të gjithë anëtarëve në mbledhjen e parë të tyre.
- b. Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për KSBCF. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të KSBCF-së, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit.
- c. Anëtarët e Komisioneve duhet të plotësojnë këto kritere:
- përfaqësuesit e personelit akademik duhet:
 - të zotërojnë së paku gradën shkencore "Doktor"
 - të kenë përvojë pune si anëtarë të personelit akademik për një periudhë së paku pesëvjeçare me kohë të plotë;
 - të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
 - të kenë eksperiencë në hartimin e raportit të vetëvlersimit edhe/ose në procesin e akreditimit;
 - përfaqësues të studentëve, duhet të jetë student me mesatare të përgjithshme mbi 8.0,
 - përfaqësuesit e personelit ndihmës akademik duhet:
 - të kenë përvojë pune si anëtarë të personelit akademik për një periudhë së paku pesëvjeçare me kohë të plotë;
 - të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
 - të kenë eksperiencë në hartimin e raportit të vetëvlersimit edhe/ose në procesin e akreditimit.
- d. Funksionet e këtij komisioni lidhen me garantimin e standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimit për të tre ciklet. Komisioni ushtron kryesisht këto funksione:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Anëtarët e këtij komisioni vetëkandidohen dhe zgjidhen respektivisht nga SA-ja, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Kryetari i komisionit zgjidhet nga anëtarët e KSAKKI me shumicë votash të të gjithë anëtarëve në mbledhjen e parë të tyre.

b) Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për KSAKKI. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të KSAKKI, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit.

c) Anëtarët e Komisioneve duhet të plotësojnë këto kritere;

i. përfaqësuesit e personelit akademik duhet:

- të zotërojnë së paku gradën shkencore "Doktor"
- të kenë përvojë pune si anëtarë të personelit akademik për një periudhë së paku pesëvjeçare me kohë të plotë;
- të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- të kenë eksperiencë në hartimin e raportit të vetëvlersimit edhe/ose në procesin e akreditimit;

ii. përfaqësues të studentëve, duhet të jetë student me mesatare të përgjithshme mbi 8.0.

iii. përfaqësuesit e personelit ndihmës akademik dhe administrativ duhet:

- të kenë përvojë pune si anëtarë të personelit akademik për një periudhë së paku pesëvjeçare me kohë të plotë;
- të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- të kenë eksperiencë në hartimin e raportit të vetëvlersimit edhe/ose në procesin e akreditimit.

d) Funksionet kryesore të këtij komisioni lidhen me garantimin e standardeve të marrëdhënieve të institucionit me studentët, alumnin dhe këshillimin e karrierës. KSAKKI i kushton një vëmendje të veçantë marrëdhënieve të institucionit me studentët, shërbimeve akademike dhe administrative ndaj tyre, si dhe marrëdhënieve të tyre me personelin, strukturat, autoritetet/organet drejtuese të institucionin. Komisioni ushtron kryesisht këto funksione:

i. Mbështet organet dhe autoritetet drejtuese të UV-së në hartimin e politikave për mbrojtjen dhe mbështetjen e studentëve;

ii. Bashkëpunon me struktura të tjera në nivel institucioni si dhe bashëkpuntorë të jashtëm për mbështetjen e studentëve;

iii. Harton politikat për mbështetjen e studentëve;

iv. Bashkëpunon me Këshillat Studentorë dhe koordinatorin e studentëve dhe koordinon punën me ta;

v. Propozon rekomandime për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara studentëve prej stafit administrativ dhe ndihmës-akademik në bazë të analizës së rezultateve të dala nga pyetësorët e studentëve;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- vi. Monitoron mbarrvajtjen e plotësimi të pyetësorit për vlersimin e Institucionit, e programeve të studimit dhe lëndëve specifike;
 - vii. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj KSAKKI mbështetet nga strukturat e tjera të ngritura me qëllim marrëdhëniet me studentët;
 - viii. Në bashkëpunim me njësitë përkatëse në Rektorat organizon aktivitete të ndryshme me fokus studentët;
 - ix. Brenda muajit shtator të çdo viti kalendarik, harton dhe publikon raportin vjetor të veprimtarisë së tij me gjetjet dhe rekomandimet për garantimin e standardeve të marrëdhënieve të institucionit me studentët;
 - x. Harton rregulloren e vet si dhe planin e punës;
 - xi. Kryen çdo funksion tjetër të ngarkuar nga autoritetet dhe organet drejtuese të UV-s në fushën e marrëdhënieve me studentët.
- e) Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj KSAKKI mbështetet nga strukturat/ organet e tjera në nivel njësie kryesore/nivel institucioni të ngritura me qëllim garantimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit midis organeve drejtuese të UV-së dhe të studentëve dhe/apo organizmave studentorë.

2.4 Komisioni i dhënies së gradës shkencore "Doktor" për çdo njësi kryesore (KDGDF);

- a) Komisioni përbëhet nga 7 anëtarë. Asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore përzgjedh nga personeli akademik I njësisë kryesore përkatëse anëtarët e KDGF-së. Ata mbajnë titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar". Anëtarët e këtij komisioni kanë mandate dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
- b) Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për komisionin doktorat. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të komisionit, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit.
- c) Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore që zhvillon një program studimi të ciklit të tretë, e krijon menjëherë këtë komision, ndërsa fakultetet e tjera e krijojnë atë pasi të kenë marrë miratimin përkatës për të zhvilluar këtë nivel program dhe cikli studimi.

2.5 Komisioni i promovimit të personelit akademik.

- a) Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik përbëhet nga 7 anëtarë. Senati Akademik përzgjedh nga personeli akademik i Njësisë Kryesore anëtarët e komisionit të Dhënies së Titujve Akademike. Ata mbajnë titullin "Profesor" dhe vetëkandidohen. Anëtarët e këtij komisioni kanë mandate dyvjeçar me të drejtë rizgjedhje. Bazuar në aktet nënligjore, komisioni m miratimin e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

SA-së mund të vendosë edhe kritere të tjera, përveç kritereve standard sipas fushave të studimit dhe nevojave të universitetit.

- b) Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për Komisionin e Promovimit të Personelit Akademik. Kur nuk ka të tillë, Senati Akademik shpall vendin vakant dhe zgjedh anëtarin e r nga personeli i vetëkandiduar, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit.
- 3. Organizimi dhe funksionimi i këtyre Komisioneve përcaktohen në këtë Statut, në Rregulloren e UV-së si dhe në rregulloret e tyre të brendshme.
 - a) Një anëtar i personelit akademik me kohë të plotë nuk mund të jetë anëtar në një komision tjetër të përhershëm. Përfshihen këtu anëtarët e komisioneve sipas pikës 2 gërma d dhe e e këtij neni.
 - b) Një anëtar i personelit ndihmës akademik, administrativ apo student, nuk mund të jetë anëtar në një komision tjetër të përhershëm.
- 2. Vendimi i përcillet për miratim të mëtejshëm Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. As. Xhiliola AGARAJ

(shkrim)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE PËRPUTHSHMËRISË PËR
ARSIMIN, SPORTIN DHE RININËDREJTORIA E PROGRAMIMIT, STANDARDIZIMIT DHE HARMONIZIMIT TË
KUADRIT RREGULLATORNr. 4350/1 Prot.Tiranë, më 9.9. 2021

15.3.21

Lënda: Kthim përgjigje

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE

Adresa: Lagjja "Pavarësia", Bulevardi Vlorë-Skelë, Vlorë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 1255 prot., datë 02.08.2021, regjistruar në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 4350 prot., datë 06.08.2021, ju bëjmë me dije se me qëllim miratimin e ndryshimeve në statut në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", parë në tërësinë e tyre, nevojitet kryerja e disa plotësimeve/ndryshimeve nga ana juaj, si vijon:

- a) Nga shqyrtimi i praktikës konstatohet se drafti i ndryshimeve në statut që është sjellë për miratim në MASR nuk është i njëjtë me versionin e miratuar me vendim të Senatit Akademik. Te drafti bashkëlidhur vendimit të Senatit Akademik neni 22 ka një pikë 3 me dy nënpika "a" dhe "b", ndërsa sipas versionit të sjellë për miratim dhe draftit bashkëlidhur vendimit të Bordit të Administrimit në nenin 22 nuk ka pikë 3.

Ndërkohë, lidhur me analizën ligjore të përmbajtjes së draftit të ndryshimeve në statut dhe përputhshmërisë me parashikimet e legjislacionit në fuqi, sugjerojmë si më poshtë:


- a) Të rishikohet germa "m" e nenit 25 të draft-statutit, pasi organet kolegjiale i Senati Akademik dhe bordi i administrimit nuk kanë në përbërje të tyre sekretarë, por edhe nëse mund t'u caktohet një i tillë, ai/ajo nuk mund të përfitojnë shpërblim, pasi ky akt bie ndërmjet nenet përkatëse të ligjit nr. 80/2015, si dhe me pikën 5 të vendimit nr.656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore", të ndryshuar, ku përcaktohet se:

"5. Kufiri maksimal i shpërblimit të anëtarëve në senatin akademik dhe bordin e administrimit në institucionet e arsimit të lartë publik është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj."

- b) Të rishikohet parashikimi i pikës 13, të nenit 31 të draft-statutit, pasi njësitë bazë nuk gëzojnë personalitet juridik dhe për pasojë ata nuk mund të lidhin marrëveshje.
- c) Të qartësohet përmbajtja e pikës 8 të nenit 31 të draft ndryshimeve në statut që parashikon se *"Rektori ...i paraqet administratorit të UV-së kërkesat me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare"*.
- d) Të rishikohet parashikimi i pikës 4, të nenit 40 sipas të cilit *"Bordi i Administrimit shkarkon administratorin me 2/3 (dy të tretat) e votave të anëtarëve të vet pas propozimit të Rektorit"* sepse bie në kundërshtim me ligjin 80/2015, duke qenë se rektori si organ drejtues akademik nuk mund të propozojë shkarkimin e administratorit.


Për sa më sipër, lutemi mbajtjen parasysh të sugjerimeve të mësipërme në mënyrë që Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në cilësinë e institucionit përgjegjës të vijojë me procedurat përkatëse të miratimit të tij.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK**

Nr. 306 Prot

Vlorë më, 21.12.2024

Lënda: Mbi ndryshimet e disa prej neneve të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

**REKTORIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE
PROF.DR. AURELA SALIAJ**

KËTU

Në zbatim të nenit 33 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe të Draft-Raportit për kontrollin e pajtueshmërisë së veprimtarisë së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të ushtruar nga MAS ardhur me shkresën nr.4506/1 prot, datë 15.07.2024, më poshtë po ju përcjellim ndryshimet e mëposhtme:

- **Ndryshimin e pikës 4 të nenit 10 - referuar rekomandimeve të shkresave të MAS nr.7599/3 prot, datë 14.02.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit është konfirmuar marrja dijeni e bashkimit të Departamentit të Fizikës dhe Departamentit të Matematikës në Departamentin e Matematikës dhe Fizikës. Përveç këtij ndryshimi të konfirmuar, në propozimet e përcjella për ndryshimin e statutit konstatojmë se edhe Departamenti i Shëndetit, shkronja "f", e pikës 4, të nenit 10 të statutit është ndryshuar në Departamenti i Kujdesit Shëndetsor. Në vijim MAS ka përcjellë shkrsën nr. 2731/3 prot, datë 24.06.2024, protokolluar pranë nesh me nr. 1202/1 prot datë 26.06.2024 në të cilën kërkohet të saktësohet vendimi i SA dhe BA dhe të reflektohet edhe ndryshimi i shkronjës "f", të pikës 4, nenit 10 të Statutit. Në vijim të vendimarrjes së organeve kolegjiale bëhët pasqyrimi si më poshtë në statutin e UV-së. Si dhe referuar rekomandimeve të fundit të MAS nr.4506 prot, datë 15.07.2024.**

Ishte:

**Neni 10
Njësitë bazë**

4. UV-ja përbëhet nga këto njësi bazë:

- a) Departamenti i Drejtësisë;
- b) Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë;
- c) Departamenti i Edukimit;
- ç) Departamenti i Gjuhëve të Huaja;
- d) Departamenti i Biznesit;
- dh) Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK



- e) Departamenti i Ekonomiksit;
- ë) Departamenti Infermierisë;
- f) Departamenti i Kujdesit Shëndetësor;
- g) Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare;
- gj) Departamenti i Shkencave Detare;
- h) Departamenti i Fizikës;
- i) Departamenti i Biologjisë;
- j) Departamenti i Matematikës;
- k) Departamenti i Shkencave Kompjuterike;
- l) Departamenti i Kimisë.

Bëhet:

Neni 10
Njësitë bazë

4. UV-ja përbëhet nga këto njësi bazë:

Fakulteti Shkencave Humane:

- m) Departamenti i Drejtësisë;
- n) Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë;
- o) Departamenti i Edukimit;
- ç) Departamenti i Gjuhëve të Huaja;

Fakulteti i Ekonomisë:

- a) Departamenti i Biznesit;
- b) Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit;
- c) Departamenti i Ekonomiksit;

Fakulteti i Shëndetit:

- a) Departamenti Infermierisë;
- b) Departamenti i Kujdesit Shëndetësor;
- c) Qendra Kërkimore Shkencore për Shëndetin Publik

Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore:

- a) Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare;
- b) Departamenti i Shkencave Detare;
- c) Departamenti i Biologjisë;
- d) Departamenti i Matematikës dhe Fizikës;
- e) Departamenti i Shkencave Kompjuterike;
- f) Departamenti i Kimisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK

- **Shtimin e pikës 3 të nenit 11:** Qendra e kërkimit shkencor nëse do të jetë pjesë e strukturës së njësive kryesore për plotësimin e standardeve të kësaj njësie, duhet të përbëhet nga të paktën 7 anëtarë, nga të cilët, të paktën 3 të jenë me grada shkencore ose tituj. Drejtuesi zgjidhet sipas rregullave të zgjedhjes së drejtuesit të njësive bazë.
- **Ndryshimin e Nenit 13 Njësitë ndihmëse,** referuar rekomandimeve të fundit të MAS nr.4506 prot, datë 15.07.2024, ku është lënë rekomandim se: *"Te fakultetet nuk janë përcaktuar ndihmës-akademie me karakter administrativ, strukturat administrative dhe strukturat ndihmës akademike me karakter akademik"*.

Ishte:

1. Strukturat ndihmës-akademike me karakter administrative në nivel institucioni janë:

A. Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore

- a) Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës;
- b) Sektorit i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun;
- c) Sektori i IT-së;

B. Sektori Juridik

C. Qendra Studimore Ndërdisciplinore e Zhvillimit Rajonal

D. Drejtoria e Edukimit për Ciklin e I&II

- a) Sektori i Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve;
- b) Sektori i këshillimit të karrieres, Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore-Sportive;

E. Sektori i Biblotekës Shkencor.

F. Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve

- a) Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional;
- b) Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

G. Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik

2. Këto struktura janë në varësi të Rektorit dhe ndihmojnë në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe /ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë.

3. Njësitë ndihmëse me karakter administrativ përbëhen nga personel administrativ dhe janë në varësi të administratorit.

Në varësi të administratorit janë:

A. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

- a) Sektori i Financës dhe Realizimit të Buxhetit;
- b) Sektori i Prokurimeve;
- c) Sektori i Shërbimeve.

Në varësi të Bordit të Administrimit është:


- a) Sektori i Auditit të Brendshëm.

Bëhet:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI JURIDIK



Struktura Akademike në nivel institucioni

1. Senati Akademik
2. Rektorati
3. Rektori
4. Zv.Rektori Akademik
5. Zv.Rektori për Marrdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor

Struktura ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel institucioni

1. Sektori i kurrikulave dhe statistikave
2. Sektori i kërkimit shkencor dhe projekteve
3. Sektori i marrdhënieve me jashtë
4. Sektori i promovimit dhe marrdhënieve me publikun
5. Sektori i karrierës, shërbimit të studentëve dhe alumni
6. Sektori i sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe akreditimit
7. Sektori i bibliotekës dhe botimeve
8. Sektori IT
9. Sektori juridik
10. Sektori i Arkiv-Protokollit dhe Burimeve Njerëzore
11. Qendra e Zhvillimit Rajonal
12. Asistenti i Rektorit

Struktura Administrative në nivel institucioni


1. Bordi i Administrimit
2. Administratori
3. Sektori i Auditimit të brendshëm
4. Sektori ekonomik
5. Sektori i prokurimeve dhe investimeve
6. Sektori i shërbimeve

Struktura Akademike në nivel njësie kryesore

1. Dekanati
2. Dekan
3. Zv.dekan akademik
4. Zv.dekan për kërkimin shkencor

Struktura ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel njësie kryesore

1. Sekretaria mësimore
2. Asistenti i Dekanit / Specialist i Arkiv-Protokollit
3. Sektori i Shërbimeve Ndihmës/akademike
 - a. Biblioteka
 - b. Zyra IT
 - c. Zyra e studentëve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK**



Struktura administrative në nivel njësie kryesore

1. Sektori i Shërbimeve Administrative
 - a. Financë – specialist
 - b. Shërbime: mirëmbajtës, punonjës pastrimi.

Struktura ndihmës akademike me karakter akademik në nivel njësie bazë

1. Laborant

**Struktura ndihmës akademike me karakter akademik në nivel Qendre
kërkimore/shkencore**

1. Specialist
2. Laborant

- **Ndryshimin e pikës 1 të nenit 18**

Ishte:

Neni 18

Mbarimi i mandatit të anëtarit të Senatit Akademik

1. Mandati i anëtarit të Senatit Akademik mbaron kur:
 - a) jep dorëheqjen;
 - b) largohet nga UV-ja;
 - c) bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrojë funksionin;
 - ç) nuk merr pjesë për 3 (tri) herë radhazi, pa shkaqe të arsyeshme në mbledhjet e Senatit Akademik;
 - d) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - dh) nuk jeton më.

Bëhet:

Neni 18

Mbarimi i mandatit të anëtarit të Senatit Akademik

1. Mandati i anëtarit të Senatit Akademik mbaron kur:
 - e) me mbarimin e afatit;
 - f) jep dorëheqjen;
 - g) largohet nga UV-ja; kur ndërpret marrëdhëniet e punës me UV-në;
 - h) bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrojë funksionin;
 - ç) nuk merr pjesë për 3 (tri) herë radhazi, pa shkaqe të arsyeshme në mbledhjet e Senatit Akademik;
 - i) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - j) mbush moshën e pensionit;
 - dh) nuk jeton më.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK

- **Ndryshimin e nenit 22** këto propozime janë bërë që prej vitit 2021 nga strukturat përkatëse në Rektorat dhe vijnë në zbatim të nenit 46 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"

Ishte:

Neni 22

Komisionet e përhershme

1. Komisionet e përhershme janë organe kolegjinale, që kryejnë funksione në fushat e përcaktuara në statut, që lidhen kryesisht me kualifikimin shkencor dhe promovimin akademik, garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, me mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikat e institucionit.
2. Komisionet e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme për çdo njësi kryesore (KSBCF):
 - a) Këto komisione përbëhen nga 7 anëtarë nga të cilët 6 janë personel akademik dhe 1 student, që vetëkandidohen dhe zgjidhen respektivisht nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore midis anëtarëve të saj, me përfaqësues nga të gjithë departamentet dhe që kanë së paku gradën shkencore "Doktor i shkencave", si dhe studentët me kohë të plotë të njësisë kryesore për përfaqësuesin e tyre, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
 - b) Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për KSBCF. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të KSBCF-së, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit.
 - c) Funksionet kryesore të këtyre komisioneve lidhen me garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit si në aspektin akademik, dhe në atë administrativ. KSBCF-të i kushtojnë një vëmendje të veçantë procesit mësimor për çdo program studimi, rezultateve akademike të studentëve dhe marrëdhënieve të tyre me personelin akademik, si dhe realizojnë studime gjurmuese lidhur me ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programit të ofruar.
 - ç) Në ushtrim të këtyre funksioneve KSBCF-ja harton rekomandime drejtuar KSBC-së në nivel institucional, autoriteteve apo organeve drejtuese, sipas natyrës së problematikës të konstatuar, mbi parregullsitë e vërejtura së bashku me propozimet përkatëse. Në rast se, pavarësisht këtyre rekomandimeve, situata nuk ndryshon, KSBCF-ja vendos në dijeni sipas rastit Këshillin e Etikës, Senatin Akademik ose Rektorin për marrjen e masave përkatëse.
 - d) Minimalisht në përfundim të çdo sezoni mësimor të vitit akademik, KSBCF-të nxjerrin rekomandime mbi standardet e cilësisë në njësinë kryesore përkatëse.
 - dh) Mënyra e funksionimit të komisionit përcaktohet në rregulloren e brendshme të UV-së.
3. Komisioni i Sigurimit të Cilësisë së Brendshme në nivel institucional (KSBCI):
 - a) Ky komision përbëhet nga 7 anëtarë nga të cilët 6 janë personel akademik dhe 1 student, që vetëkandidohen dhe zgjidhen respektivisht nga SA-ja, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SEKTORI JURIDIK

- b) Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për KSBCI. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të KSBCI-së, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit.
- c) Funksionet kryesore të këtij komisioni lidhen me garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit si në aspektin akademik, dhe në atë administrativ.
- ç) KSBCI-ja e institucionit i kushton një vëmendje të veçantë procesit mësimor për çdo program studimi, rezultateve akademike të studentëve dhe marrëdhënieve të tyre me personelin akademik, realizon studime gjurmuese lidhur me ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programit të ofruar.
- d) Në ushtrim të këtyre funksioneve KSBCI-ja e institucionit harton rekomandime drejtuar autoriteteve apo organeve drejtuese, sipas natyrës së problematikës të konstatuar mbi parregullsitë e vërejtura së bashku me propozimet përkatëse. Në rast se, pavarësisht këtyre rekomandimeve, situata nuk ndryshon, KSBCI-ja vendos në dijeni sipas rastit Këshillin e Etikës, Senatin Akademik ose Rektoren për marrjen e masave përkatëse.
- dh) Minimalisht në përfundim të çdo sezoni mësimor të vitit akademik, KSBCI-ja nxjerr rekomandime mbi standardet e cilësisë në nivel institucional.
- e) Mënyra e funksionimit të komisionit përcaktohet në rregulloren e brendshme të UV-së.
4. Komisionet e marrëdhënieve me studentët për çdo fakultet (KMSF):
- a) Këto komisione përbëhen nga 7 anëtarë nga të cilët 6 janë personel akademik dhe 1 student, që vetëkandidohen dhe zgjidhen respektivisht nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore midis anëtarëve të saj dhe studentët me kohë të plotë të njësisë kryesore për përfaqësuesin e tyre, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
- b) Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për KMSF. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të KMSF, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit.
- c) Funksionet kryesore të këtyre komisioneve lidhen me garantimin e standardeve të marrëdhënieve të fakultetit me studentët. KMSF-të i kushtojnë një vëmendje të veçantë marrëdhënieve të fakultetit me studentët, shërbimeve akademike dhe administrative ndaj tyre, rezultateve akademike dhe marrëdhënieve të tyre me personelin, strukturat, autoritetet/organet drejtuese të fakultetit.
- ç) Në ushtrim të këtyre funksioneve, KMSF-ja harton rekomandime drejtuar KMSI-së, autoriteteve apo organeve drejtuese, sipas natyrës së problematikës të konstatuar, mbi parregullsitë e vërejtura së bashku me propozimet përkatëse. Në rast se, pavarësisht këtyre rekomandimeve, situata nuk ndryshon, KMSF-ja vendos në dijeni sipas rastit Këshillin e Etikës, Senatin Akademik ose Rektoren për marrjen e masave përkatëse. Minimalisht në përfundim të çdo sezoni mësimor të vitit akademik, KMSF-të nxjerrin rekomandime mbi standardet e cilësisë në njësinë kryesore përkatëse.
5. Komisionet e marrëdhënieve me studentët në nivel institucional (KMSI):
- a) Këto komisione përbëhen nga 7 anëtarë nga të cilët 6 janë personel akademik dhe 1 student, që vetëkandidohen dhe zgjidhen respektivisht nga asambleja e personelit akademik të institucionit midis anëtarëve të saj dhe studentët me kohë të plotë të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI JURIDIK



njesisë kryesore për përfaqësuesin e tyre, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

b) Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për KMSI. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të KMSI-së, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit.

c) Funkcionet kryesore të këtyre komisioneve lidhen me garantimin e standardeve të marrëdhënies së institucionit me studentët. KMSI-të i kushtojnë një vëmendje të veçantë marrëdhënieve të UV-së me studentët, shërbimeve akademike dhe administrative ndaj tyre, rezultateve akademike dhe marrëdhënieve të tyre me personelin, strukturat, autoritetet/organet drejtuese të institucionit.

ç) Në ushtrim të këtyre funksioneve KMSI-ja harton rekomandime drejtuar autoriteteve apo organeve drejtuese, sipas natyrës së problematikës të konstatuar, mbi parregullsitë e vërejtura së bashku me propozimet përkatëse. Në rast se, pavarësisht këtyre rekomandimeve, situata nuk ndryshon, KMSF-ja vendos në dijeni, në mënyrë përfundimtare, sipas rastit Këshillin e Etikës, Senatin Akademik ose Rektorin për marrjen e masave përkatëse. Nëse nuk merren masa adekuate, KMSI-të i drejtohen Asamblesë së Personelit Akademik. Minimalisht në përfundim të çdo sezoni mësimor të vitit akademik, KMSI-të nxjerrin rekomandime mbi standardet e cilësisë në njësinë kryesore përkatëse.

d) Mënyra e funksionimit të komisionit përcaktohet në Rregulloren e brendshme të UV-së.

6. Komisioni i dhënies së gradës shkencore "Doktor" për çdo fakultet (KDGDF):

a) Komisionet përbëhen nga 7 anëtarë. Asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore përzgjedh nga personeli akademik i njësisë kryesore përkatëse anëtarët e KDGF-së. Ata mbajnë titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar". Anëtarët e këtij komisioni kanë mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për komisionin doktoral. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të komisionit, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit.

b) Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore që zhvillon një program studimi të ciklit të tretë, e krijon menjëherë këtë komision, ndërsa fakultetet e tjera e krijojnë atë pasi të kenë marrë miratimin përkatës për të zhvilluar këtë nivel programi dhe cikli studimi.

7. Komisioni i i Promovimit të Personelit Akademik:

a) Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik përbëhet nga 7 anëtarë. Senati Akademik përzgjedh nga personeli akademik i njësive kryesore anëtarët e Komisionit të Dhënies së Titujve Akademikë. Ata mbajnë titullin "Profesor" dhe vetëkandidohen. Anëtarët e këtij komisioni kanë mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Bazuar në aktet nënligjore, komisioni me miratimin e SA-së mund të vendosë edhe kritere të tjera, përveç kritereve standarde, sipas fushave të studimit dhe nevojave të universitetit.

b) Mënyra e funksionimit të komisioneve të përhershme përcaktohet në rregulloren e Universitetit.

c) Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për Komisionin e Promovimit të Personelit Akademik. Kur nuk ka të tillë, Senati shpall vendin vakant dhe zgjedh anëtarin e ri nga personeli i vetëkandiduar, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK**



Bëhet:

Neni 22

Komisionet e përhershme

1. Komisionet e përhershme janë organe kolegjinale, të krijuara në nivel institucional dhe në nivel të njërive kryesore, që kryejnë funksione në fushat e përcaktuara në statut, që lidhen kryesisht me kualifikimin shkencor dhe promovimin akademik, garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, si dhe me mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikat e institucionit.
2. Në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë ngrihen dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre këto Komisione të Përhershme:
 - a. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni (KSBCI);
 - b. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për çdo njësi kryesore (KSBCF);
 - c. Komisioni për studentët, alumnin dhe këshillimin e karrierës në nivel institucional (KSAKKI)
 - d. Komisioni për studentët, alumnin dhe këshillimin e karrierës në nivel njësie kryesore (KSAKKF)
 - e. Komisioni i dhënies së gradës shkencore "Doktor" për çdo njësi kryesore (KDGDF);
 - f. Komisioni i promovimit të personelit akademik.
3. Komisionet e përhershme në nivel institucional në UV janë:
 - a) Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni (KSBCI). Ky komision përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 4 (katër) janë anëtarë nga personeli akademik i UV-së që i përkasin kategorisë "Profesor" ose/dhe "Lektor" dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve.
 - b) Komisioni për studentët, alumnin dhe këshillimin e karrierës në nivel institucional (KSAKKI). Ky komision përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 4 (katër) janë anëtarë nga personeli akademik i UV-së që i përkasin kategorisë "Profesor" ose/dhe "Lektor" dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve.
 - c) Komisioni i promovimit të personelit akademik. Ky komision përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë personel akademik i UV-së, që mbajnë titullin "Profesor".
4. Anëtarët e komisioneve të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një mandate 2 (dy vjeçar), me të drejtë rizgjedhje.
5. Anëtarët e komisioneve të përhershme në nivel njësie kryesore në UV janë:
 - a) Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për çdo njësi kryesore (KSBCF). Ky komision përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 4 (katër) janë anëtarë nga personeli akademik i njësisë kryesore që i përkasin kategorisë "Profesor" ose/ dhe "Lektor" dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve.
 - b) Komisioni i dhënies së gradës shkencore "Doktor" për çdo njësi kryesore (KDGDF); ky komision përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë nga personeli akademik i njësisë kryesore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK**

- që i përkasin kategorisë "Profesor" ose "Profesor i Asociuar". Anëtarët e këtij komisioni kanë mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
- c) Komisioni për studentët, alumnin dhe këshillimin e karrierës në nivel njësie kryesore (KSAKKF) Ky komision përbëhet nga nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 4 (katër) janë anëtarë nga personeli akademik i njësisë kryesore që i përkasin kategorisë "Profesor" ose/ dhe "Lektor" dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve.
6. Anëtarët e komisioneve të përcaktuara në pikën 5 të këtij neni vetëkandidohen dhe zgjidhen nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore midis anëtarëve të saj, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
- **Ndryshim i pikës 3 të nenit 17 Senati Akademik**

Ishte:

3. Numri i anëtarëve të Senatit Akademik të UV-së është 23, duke përfshirë dhe Rektorin e UV-së.

Bëhet:

3.Shfuqizohet.

- **Ndryshimin e pikës 1, gërma m, p të nenit Neni 25 Funksionet e Bordit të Administrimit në zbatim të shkresës nr. 1079/3 prot, datë 12.05.2021, shkresës nr.4350/1 prot, datë 09.09.2021 të MAS, bashkëlidhur këtij propozimi.**

Ishte:

- m) përcakton dhe miraton masën e shpërblimit të anëtarëve të Bordit të Administrimit, Senatit Akademik si dhe sekretarëve respektivë;
- p) përcakton dhe miraton masën e shpërblimit të anëtarëve të komisioneve të përhershme;

Bëhet:


- m) përcakton dhe miraton masën e shpërblimit të anëtarëve të Bordit të Administrimit, Senatit Akademik .
- p) shfuqizohet; pasi është e njëjtë me gërmën n të po këtij neni.

- **Saktësim të pikës 1, gërma f), të nenit 26 Rektorati si dhe shtim të pikës 4 dhe 5 duke përcaktuar mënyrën e mbledhjes së këtij organi kolegjal në zbatim dhe të rekomandime të MAS nr.4506 prot, datë 15.07.2024, ku citohet: "Konstatohet se procesverbali është firmosur vetëm nga mbajtësi i procesverbalit dhe nuk është firmosur nga anëtarët e pranishëm në mbledhjen e senatit akademik dhe nuk është e qartë shumica me të cilët janë marrë vendimet".**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK



Ishte:


Neni 26
Rektorati

1. Rektorati në institucionet e arsimit të lartë është organ kolegjal që drejtohet nga Rektori dhe përbëhet nga:
 - a) rektori;
 - b) zëvendësrektori/ët;
 - c) administratori i institucionit;
 - ç) drejtuesit e njësive kryesore.
2. Rektorati në mbledhjet e tij mund të ftojë edhe personel tjetër në varësi të natyrës specifike të çështjes së shtruar për diskutim.
3. Rektorati ka këto funksione kryesore:
 - a) harton dhe paraqet në Senatin Akademik projekt-planin e zhvillimit strategjik të institucionit;
 - b) formulon kriteret për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore;
 - c) përcakton përparësitë në plotësimin e kërkesave të njësive të institucionit për financime, mbi të cilat do të hartohet projekt-buxheti vjetor;
 - ç) propozon rekomandime në SA për programet e studimit dhe kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
 - d) propozon rekomandime në SA për strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit për të gjitha nivelet;
 - dh) propozon në SA për miratim planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore shkencore;
 - e) propozon në SA për miratim raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit;
 - ë) paraqet rekomandime në SA mbi projekt-marrëveshjet, bashkëpunimet apo anëtarësimet e institucionit në organizma apo institucione kombëtare ose ndërkombëtare;
 - f) merr masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të Senatit Akademik;
 - g) harton dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit;
 - gj) propozon në SA Kodin e Etikës.

Bëhet:

Neni 26
Rektorati

1. Rektorati në institucionet e arsimit të lartë është organ kolegjal që drejtohet nga Rektori dhe përbëhet nga:
 - a) rektori;
 - b) zëvendësrektori/ët;
 - c) administratori i institucionit;
 - ç) drejtuesit e njësive kryesore.
2. Rektorati në mbledhjet e tij mund të ftojë edhe personel tjetër në varësi të natyrës specifike të çështjes së shtruar për diskutim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI JURIDIK



3. Rektorati ka këto funksione kryesore:
- h) harton dhe paraqet në Senatin Akademik projekt-planin e zhvillimit strategjik të institucionit;
 - i) formulon kriteret për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore;
 - j) përcakton përparësitë në plotësimin e kërkesave të njëjësive të institucionit për financime, mbi të cilat do të hartohet projekt-buxheti vjetor;
 - ç) propozon rekomandime në SA për programet e studimit dhe kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
 - k) propozon rekomandime në SA për strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit për të gjitha nivelet;
 - dh) propozon në SA për miratim planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore shkencore;
 - l) propozon në SA për miratim raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit;
 - ë) paraqet rekomandime në SA mbi projekt-marrëveshjet, bashkëpunimet apo anëtarësimet e institucionit në organizma apo institucione kombëtare ose ndërkombëtare;
 - m) merr masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të Senatit Akademik që i ngarkohen këtij organi;
 - n) harton dhe paraqet për miratim rregulloren e UV-së;
 - gj) propozon në SA Kodin e Etikës.
4. Mbledhja e Rektoratit thirret nga Rektori ose të paktën një e treta e anëtarëve të tij. Për çdo mbledhje të Rektoratit mbahet procesverbal. Rektorati shprehet me vendime dhe udhëzime për çështjet që merren në shqyrtim.
5. Rektorati harton rregulloren e funksionimit të tij, e cila miratohet nga Senati Akademik.

- Në nenin 27 shtohet pika 2, 3, 5 dhe 6 në bazë të rekomandimeve të MAS nr.4506 prot, datë 15.07.2024, ku citohet: *"Konstatohet se procesverbali është firmosur vetëm nga mbajtësi i procesverbalit dhe nuk është firmosur nga anëtarët e pranishëm në mbledhjen e senatit akademik dhe nuk është e qartë shumica me të cilët janë marrë vendimet"*.


ISHTE:

Neni 27
Dekanati

1. Dekanati në institucionet e arsimit të lartë është organ kolegjal që drejtohet nga dekani dhe përbëhet nga:
- a) dekani;
 - b) zëvendësdekanët;
 - c) administratori i njësisë kryesore;
 - ç) drejtuesit e njësive bazë.
2. Dekanati ka këto funksione kryesore:
- a) koordinon veprimtarinë e njësive bazë të fakultetit;
 - b) diskuton dhe propozon në rektorat masa për zhvillimin dhe funksionimin e njësive kryesore;
 - c) diskuton paraprakisht probleme që lidhen me programet e studimit, kriteret e pranimit në këto programe, shpërndarjen e financimeve dhe përparësitë e zhvillimit të fakultetit;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK

- ç) diskuton dhe paraqet në Senatin Akademik projektplanin e zhvillimit strategjik të njësive kryesore mbi bazën e propozimeve të njësive bazë;
- d) përcakton dhe propozon në rektorat përparësitë në plotësimin e kërkesave të njësive të njësive bazë për financime, mbi të cilat do të hartohet projektbuxheti vjetor;
- dh) paraqet rekomandime në rektorat dhe SA mbi programet e studimit dhe kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre, sipas propozimeve të njësive bazë;
- e) paraqet në rektorat për miratim planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore shkencore të njësive kryesore, sipas propozimeve të njësive bazë;
- ë) paraqet në rektorat për miratim raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së fakultetit, mbështetur në raportet e hartuara nga njësitë bazë;
- f) merr masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të Senatit Akademik, Rektoratit, Rektorit dhe zëvendësrektorëve;
- g) harton dhe miraton paraprakisht rregulloren e brendshme të funksionimit të fakultetit, dhe çdo lloj rregulloreje tjetër, përpara miratimit përfundimtar nga SA;
- gj) jep lejet etike për të kryer kërkim/mbledhur të dhëna për punimet dhe projektet kërkimore shkencore;
- h) kompetenca më të detajuara përcaktohen në rregulloren e Universitetit.

Bëhet:

Neni 27
Dekanati

1. Dekanati në institucionet e arsimit të lartë është organ kolegjal që drejtohet nga dekani dhe përbëhet nga:
 - a) dekani;
 - b) zëvendësdekanët;
 - c) administratori i njësive kryesore;
 - ç) drejtuesit e njësive bazë.
2. Në mbledhjen e dekanatit mund të thirren edhe persona të tjerë sipas nevojës.
3. Mënyra e thirrjes, e funksionimit dhe e organizimit të dekanatit zhvillohet në përputhje me rregulloren e fakultetit.
4. Dekanati ka këto funksione kryesore:
 - i) koordinon veprimtarinë e njësive bazë të fakultetit;
 - j) diskuton dhe propozon në rektorat masa për zhvillimin dhe funksionimin e njësive kryesore;
 - k) diskuton paraprakisht probleme që lidhen me programet e studimit, kriteret e pranimi në këto programe, shpërndarjen e financimeve dhe përparësitë e zhvillimit të fakultetit;
 - ç) diskuton dhe paraqet në Senatin Akademik projek-tplanin e zhvillimit strategjik të njësive kryesore mbi bazën e propozimeve të njësive bazë;
 - l) përcakton dhe propozon në rektorat përparësitë në plotësimin e kërkesave të njësive të njësive bazë për financime, mbi të cilat do të hartohet projektbuxheti vjetor;
 - dh) paraqet rekomandime në rektorat dhe SA mbi programet e studimit dhe kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre, sipas propozimeve të njësive bazë;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI JURIDIK




- m) paraqet në rektorat për miratim planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore shkencore të njësisë kryesore, sipas propozimeve të njësisë bazë;
 - ë) paraqet në rektorat për miratim raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së fakultetit, mbështetur në raportet e hartuara nga njësitë bazë;
 - n) merr masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të Senatit Akademik, Rektoratit, Rektorit dhe zëvendësrektorëve;
 - o) harton dhe miraton paraprakisht rregulloren e brendshme të funksionimit të fakultetit, dhe çdo lloj rregulloreje tjetër, përpara miratimit perfundimtar nga SA;
 - gj) jep lejet etike për të kryer kërkim/mbledhur të dhëna për punimet dhe projektet kërkimore shkencore;
 - p) kompetenca më të detajuara përcaktohen në rregulloren e Universitetit.
5. Dekanati mbledhet periodikisht dhe për çdo mbledhje mbahet procesverbal i cili pas zbardhjes duhet të firmoset nga gjithë anëtarët e Dekanatit prezent në mbledhje.
 6. Dekanati shprehet me vendime dhe udhëzime për çështjet që merren në shqyrtim.
 7. Dekanati ushtron funksione të tjera të parashikuara në këtë Statut dhe akte të tjera të Universitetit.
- **Saktësimin e nenit 28 Këshilli i etikës MAS nr.4506 prot, datë 15.07.2024, ku citohet:**
"Konstatohet se procesverbali është firmosur vetëm nga mbajtësi i procesverbalit dhe nuk është firmosur nga anëtarët e pranishëm në mbledhjen e senatit akademik dhe nuk është e qartë shumica me të cilët janë marrë vendimet".

Ishte :

Neni 28
Këshilli i Etikës

1. Këshilli i Etikës i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë promovon dhe shqyrton çështje, që lidhen me etikën në veprimtarinë e institucionit, në fushën akademike dhe në atë kërkimore-shkencore.
2. Këshilli i Etikës përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, katër prej të cilëve personel akademik me kohë të plotë, nga një për çdo fakultet, që mbajnë të paktën gradën shkencore "Doktor", një përfaqësues nga radhët e personelit ndihmës akademik, një nga personeli administrativ dhe një përfaqësues nga radhët e studentëve. Kandidati për anëtar vetëkandidohet dhe zgjidhet nga Senati Akademik, me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve dhe votim të fshehtë. Çdo njësi kryesore nuk mund të përfaqësohet me më shumë se një anëtar në Këshillin e Etikës. Mandati i anëtarit të Këshillit të Etikës është pesëvjeçar.
3. Nuk mund të zgjidhet anëtar në Këshillin e Etikës personeli akademik i emëruar në funksione drejtuese.
4. Këshilli i Etikës vihet në lëvizje përmes ankesave. Vendimmarrja kryhet me shumicë të cilësuar prej katër të pestave.
5. Këshilli i Etikës, në bashkëpunim me Rektoratin, përgatit dhe i propozon Senatit Akademik, Kodin e Etikës së Universitetit.
6. Këshilli i Etikës në rastin e shqyrtimit të çështjeve që lidhen me etikën në veprimtarinë e universitetit shprehet me vendim dhe i propozon Rektorit marrjen e masës disiplinore. Vendimi i Këshillit të Etikës është i ankimueshëm në Gjykatë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK

Bëhet:

Neni 28
Këshilli i Etikës

1. Këshilli i Etikës i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë promovon dhe shqyrton çështje, që lidhen me etikën në veprimtarinë e institucionit, në fushën akademike dhe në atë kërkimore-shkencore, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale sipas parashikimeve të Kodit të Etikës dhe legjislacionit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë.
2. Këshilli i Etikës është organ kolegjal, i cili përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, katër prej të cilëve personel akademik me kohë të plotë, nga një për çdo fakultet, që mbajnë të paktën gradën shkencore "Doktor", një përfaqësues nga radhët e personelit ndihmës akademik, një nga personeli administrativ dhe një përfaqësues nga radhët e studentëve. Kandidati për anëtar vetëkandidohet dhe zgjidhet nga Senati Akademik, me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve dhe votim të fshehtë. Çdo njësi kryesore nuk mund të përfaqësohet me më shumë se një anëtar në Këshillin e Etikës. Mandati i anëtarit të Këshillit të Etikës është pesëvjeçar me të drejtë rizgjedhje.
3. Nuk mund të zgjidhet anëtar në Këshillin e Etikës personeli akademik i emëruar në funksione drejtuese.
4. Këshilli i Etikës vihet në lëvizje përmes ankesave. Vendimmarrja kryhet me shumicë të cilësuar prej katër të pestave.
5. Këshilli i Etikës, në bashkëpunim me Rektoratin, përgatit dhe i propozon Senatit Akademik, Kodin e Etikës së Universitetit. Projekt-kodi i përgatitur nga Këshilli i Etikës, përpra se të dërgohet për miratim në Senatin Akademik duhet të kalojë për konsultim në të gjitha njësitë kryesore si dhe zyrën juridike të UV-së.
6. Këshilli i Etikës në rastin e shqyrtimit të çështjeve që lidhen me etikën në veprimtarinë e universitetit shprehet me vendim dhe i propozon Rektorit marrjen e masës disiplinore.
7. Vendimi i Këshillit të Etikës është i ankimueshëm në Gjykatë.

• **Në nenin 30 janë shtuar pika 4 dhe 5**

1. Rektori zgjidhet nga anëtarët e asambleve të personelit akademik të njësisë kryesore dhe studentët. Votat e studentëve në përzgjedhjen e rektorit llogariten në masën dhjetë për qind të totalit të përgjithshëm të votave. Kandidatët për rektor vetëkandidohen dhe duhet të kenë përvojë në mësimdhënie ose kërkim shkencor jo më pak se 10 (dhjetë) vjet;
2. Kandidatët për rektor duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a. Nuk kanë qenë në ndjekje penale dhe ndaj tyre nuk është dhënë një masë e sigurimit personal;
 - b. Të kenë përvojë akademike dhe administrative
 - c. Të mos jenë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - d. Të mos kenë masë disiplinore në fuqi
 - e. Të mos kenë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 45/2015 ("Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI JURIDIK

Socialiste të Shqipërisë") dhe ligjit nr. 138/2015 ("Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike");

- f. Të mos kenë qenë rektorë të zgjedhur për dy ose më shumë mandate, të njëpasnjëshme ose të ndara në të njëjtin institucion ku do të kandidojnë. Në numrin e mandateve, sipas kësaj pike, llogariten mandatet e fituara sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim, të fituara me zgjedhje, pavarësisht kohëzgjatjes.
- g. Kriteria të tjera të vendosura në Rregulloren e zgjedhjeve të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

- Në nenin 31, në të cilin parashikohen funksionet e Rektorit të bëhen ndryshimet si më poshtë. Këto ndryshime janë të miratuara dhe më parë me Vendim SA nr. 33, 05.07.2021 dhe vijnë në zbatim të shkresës nr.4350/1 prot, datë 09.09.2021.

- **Neni 31, pika 26:**

Ishte:

Urdhëron ngritjen e komisioneve ad hoc për konkursin e punësimit të personelit akademik, të personelit ndihmësakademik me karakter mësimor, të personelit ndihmësakademik me karakter administrativ, si dhe të personelit administrativ, sipas përcaktimeve në këtë Statut.

Bëhet:

Urdhëron ngritjen e komisioneve ad hoc për konkursin e punësimit të personelit akademik, dhe personelit ndihmësakademik, sipas përcaktimeve në këtë Statut.

- **Neni 31, pika 27:**

Ishte:

Trajton ankesat e subjekteve të interesuara lidhur me procedurat e zhvillimit të konkurimit dhe vendimeve të komisioneve ad-hoc për rekrutimin e personelit akademik, të personelit ndihmësakademik me karakter mësimor, të personelit ndihmësakademik me karakter administrativ, si dhe të personelit administrativ sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në ligjin nr. 44/ 2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" dhe në këtë Statut.

Bëhet:

Trajton ankesat e subjekteve të interesuara lidhur me procedurat e zhvillimit të konkurimit dhe vendimeve të komisioneve *ad-hoc* për rekrutimin e personelit akademik dhe të personelit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK

ndihmësakademik, sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në ligjin nr. 44/ 2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" dhe në këtë Statut.

- **Neni 31, pika 29:**

Ishte:

Në përfundim të procesit të ankimimit administrativ, kur vlerëson se ankimi është i pranueshëm, me cilësinë e organit epëror, vendos me një akt të ri anulimi, shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit të komisionit *ad-hoc* për rekrutimin e personelit akademik, të personelit ndihmës akademik me karakter mësimor, të personelit ndihmësakademik me karakter administrativ, si dhe të personelit administrativ,

Bëhet:

Në përfundim të procesit të ankimimit administrativ, kur vlerëson se ankimi është i pranueshëm, me cilësinë e organit epëror, vendos me një akt të ri anulimin, shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit të komisionit *ad-hoc* për rekrutimin e personelit akademik dhe personelit ndihmësakademik.

- **Neni 31, pika 30:**

Ishte:

Miraton klasifikimin përfundimtar të konkursit të punësimit të personelit akademik (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme) dhe të personelit ndihmësakademik me karakter mësimor, të personelit ndihmësakademik me karakter administrativ, si dhe të personelit administrativ dhe emëron kandidatin/ kandidatët e shpallur fitues (me përjashtim të administratorit të UV-së, administratorëve të njësive kryesore dhe të njësive bazë).

Bëhet:

Miraton klasifikimin përfundimtar të konkursit të punësimit të personelit akademik (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme) dhe të personelit ndihmësakademik.


Emëron kandidatin/ kandidatët e shpallur fitues.

- **Neni 31, pika 39:**

Ishte:

Ushtron të drejtën e dhënies së masave disiplinore ndaj personelit akademik ndihmësakademik dhe administrativ.

Bëhet:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI JURIDIK

Ushtron të drejtën e dhënies së masave disiplinore ndaj personelit akademik dhe personelit ndihmës akademik.

- **Neni 31, pika 42:**

Ishte:

Urdhëron, pas propozimit të Administratorit ose konstatimit kryesisht, largimin nga detyra dhe zgjidhjen e marrëdhënies së punës me personelin administrativ të UV-së, (me përjashtim të administratorëve të njësive kryesore dhe njësive bazë), sipas parashikimeve të ligjit nr. 7961, datë 12. 07. 1995 "Kodi i Punës të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Bëhet:

Kjo pikë shfuqizohet.

- **Neni 31, pika 43:**

Ishte:

Urdhëron zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës me personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të UV-së, sipas parashikimeve të ligjit nr. 7961, datë 12. 07. 1995 "Kodin i Punës të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Bëhet:

Urdhëron zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës me personelin akademik, ndihmës akademik, sipas parashikimeve të ligjit nr. 7961, datë 12. 07. 1995 "Kodin i Punës të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

- **Saktësim të pikës 2 neni 32**

Ishte:

2.Zëvendësrektorët i përkasin kategorisë "Profesor" ose kanë gradën shkencore "Doktor" ("PhD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Ata janë anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë, të cilët emërohen dhe shkarkohen nga Rektori pas miratimit në Senatin Akademik.

Bëhet:

2.Zëvendësrektorët i përkasin kategorisë "Profesor" ose kanë gradën shkencore "Doktor" ("PhD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Ata janë anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë, të cilët emërohen dhe shkarkohen nga Rektori pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej tij në Senatin Akademik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK

- Ndryshimin e nenit 34 janë përcaktuar kompetenca dhe funksione të cilat mungonin në zbatim të ligjit për arsimin e lartë.

Ishte:

Neni 34


Drejtuesi i njësisë kryesore

1. Drejtuesi i njësisë kryesore në UV ushtron këto funksione:
 - a) përfaqëson njësinë kryesore në organet e UV-së dhe në marrëdhënie me të tretët për çështjet akademike dhe protokollare;
 - b) drejton dekanatin dhe raporton para tij;
 - c) drejton dhe kontrollon veprimtarinë e strukturave të njësisë kryesore për çështjet akademike dhe protokollare;
 - ç) garanton zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, të statutit dhe të rregulloreve të UV-së në njësinë kryesore;
 - d) i përcjell Senatit Akademik propozimet e njësive bazë, shoqëruar me mendimet e tij;
 - dh) i përcjell rektorit propozimet e njësive bazë, shoqëruar me mendimet e tij;
 - e) i paraqet Rektorit kërkesat e njësisë kryesore me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;
 - ë) emëron drejtues të njësisë bazë kandidatin fitues në zgjedhje;
 - f) emëron drejtuesin e njësisë bazë në rastet e krijimit të një njësie bazë të re dhe ia përcjell rektorit;
 - g) emëron titullarët e grupeve mësimore e kërkimore;
 - gj) emëron dhe shkarkon zëvendësdekanin;
 - h) i propozon rektorit shkarkimin e autoritetit drejtues të njësisë bazë në institucionet publike të arsimit të lartë në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së institucionit të arsimit të lartë. Rektori shprehet brenda një muaji. Zëvendësuesi i drejtuesit të njësisë bazë caktohet nga rektori, me propozimin e drejtuesit të njësisë kryesore;
 - i) i propozon rektorit largimin nga detyra dhe zgjidhjen e marrëdhënies së punës me personelin ndihmës akademik të njësisë kryesore, sipas parashikimeve të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
 - j) i propozon rektorit zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës me personelin akademik dhe ndihmës akademik të njësisë kryesore, sipas parashikimeve të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
 - k) miraton komisionin, që do të realizojë procedurat për njohjen dhe njësimin e periudhave të studimit për të gjitha rastet e përcaktuara në ligj dhe aktet e tjera nënligjore (rifillim studimesh, transferim studimesh etj.);
 - l) harton planin kalendarik;
 - ll) i përcjell organeve dhe autoriteteve drejtuese të UV-së të gjitha aktet që dalin nga njësia bazë dhe njësia kryesore që drejton, të shoqëruara me mendimet e tij;
 - m) miraton propozimin e njësisë bazë për përbërjen e komisioneve të provimeve të formimit, të mbrojtjes së diplomave;
 - n) nënshkruan diplomat dhe certifikatat e përfundimit të studimeve pa të drejtë të delegimit të firmës;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI JURIDIK



nj) marrëdhëniet e drejtuesit të njësisë kryesore me organet e tjera, mënyra dhe kushtet e ushtrimit të kompetencave të tij, parashikohen në Rregulloren e UV-së.

o) i propozon administratorit të institucionit shkarkimin e administratorit të njësisë kryesore.

2. Drejtuesi i njësisë kryesore në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me urdhëra, udhëzime dhe akte të tjera sipas legjislacionit në fuqi

Bëhet:


Neni 34

Drejtuesi i njësisë kryesore

1. Drejtuesi i njësisë kryesore është dekani i fakultetit. Ai drejton asamblenë e personelit akademik të njësisë kryesore.
2. Dekani është autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore dhe përfaqësuesi i saj. Ai koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve kolegjiale të njësisë kryesore so dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre.
3. Dekani zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore dhe studentët. Votat e studentëve në përzgjedhjen e drejtuesit llogariten në masën dhjetë për qind të totalit të përgjithshëm të votave. Kandidati për drejtues vetëkandidohet. Ai është personel akademik i kategorisë "Profesor" dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë ose dhe jashtë tij.
4. Kandidatët për dekan duhet:
 - a) të kenë përvojë në mësimdhënie ose kërkim shkencor jo më pak se 10 vjet;
 - b) të kenë përvojë akademike në cilësinë e titullarit të disiplinave të lëndëve, si dhe të kenë zhvilluar kurrikula, programe lëndësh, të kenë përgatitur literaturë mbështetëse dhe/ose të kenë zhvilluar projekte kërkimore etj., prej të paktën 5 vitesh;
 - c) të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
 - ç) të mos jenë dënuar më parë me një vendim të formës së prerë për vepra penale;
 - d) të mos ketë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" dhe ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
5. Mandati i drejtuesit zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit, ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.
6. Rektori i Universitetit emëron drejtues të njësisë kryesore kandidatin fitues, të dalë nga zgjedhjet.
7. Kur vendi i Dekanit mbetet i lirë, si pasojë e përfundimit të parakohshëm të mandatit për arsye të paracaktuara në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në Statut, Rektori komandon në detyrë një nga zëvendësdekanët.
8. Drejtuesi i njësisë kryesore në UV ushtron këto funksione:
 - a) përfaqëson njësinë kryesore në organet e UV-së dhe në marrëdhënie me të tretët për çështjet akademike dhe protokollare;




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK

- b) drejton dekanatin dhe raporton para tij;
- c) drejton dhe kontrollon veprimtarinë e strukturave të njësisë kryesore për çështjet akademike dhe protokollare;
- d) garanton zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, të statutit dhe të rregulloreve të UV-së në njësinë kryesore;
- e) i përcjell Senatit Akademik propozimet e njësive bazë, shoqëruar me mendimet e tij;
- f) i përcjell rektorit propozimet e njësive bazë, shoqëruar me mendimet e tij;
- g) i paraqet Rektorit kërkesat e njësisë kryesore me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;
- h) emëron drejtues të njësisë bazë kandidatin fitues në zgjedhje;
- i) emëron drejtuesin e njësisë bazë në rastet e krijimit të një njësie bazë të re dhe ia përcjell rektorit;
- j) emëron titullarët e grupeve mësimore e kërkimore;
- k) emëron dhe shkarkon zëvendësdekanin;
- l) i propozon rektorit shkarkimin e autoritetit drejtues të njësisë bazë në institucionet publike të arsimit të lartë në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së institucionit të arsimit të lartë. Rektori shprehet brenda një muaji. Zëvendësuesi i drejtuesit të njësisë bazë caktohet nga rektori, me propozimin e drejtuesit të njësisë kryesore;
- m) i propozon rektorit largimin nga detyra dhe zgjidhjen e marrëdhënies së punës me personelin ndihmës akademik të njësisë kryesore, sipas parashikimeve të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- n) i propozon rektorit zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës me personelin akademik dhe ndihmës akademik të njësisë kryesore, sipas parashikimeve të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- o) miraton komisionin, që do të realizojë procedurat për njohjen dhe njësimin e periudhave të studimit për të gjitha rastet e përcaktuara në ligj dhe aktet e tjera nënligjore (rifillim studimesh, transferim studimesh etj.);
- p) harton planin kalendarik;
- q) i përcjell organeve dhe autoriteteve drejtuese të UV-së të gjitha aktet që dalin nga njësiti bazë dhe njësia kryesore që drejton, të shoqëruara me mendimet e tij;
- r) miraton propozimin e njësisë bazë për përbërjen e komisioneve të provimeve të formimit, të mbrojtjes së diplomave;
- s) nënshkruan diplomat dhe certifikatat e përfundimit të studimeve pa të drejtë të delegimit të firmës;
- t) marrëdhëniet e drejtuesit të njësisë kryesore me organet e tjera, mënyra dhe kushtet e ushtrimit të kompetencave të tij, parashikohen në Rregulloren e UV-së.
- u) i propozon administratorit të institucionit shkarkimin e administratorit të njësisë kryesore.

9. Drejtuesi i njësisë kryesore në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me urdhëra, udhëzime dhe akte të tjera sipas legjislacionit në fuqi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK**

Ishte:

**Neni 36
Zëvendësdekani**

1. Zëvendësdekanët janë anëtarë me kohë të plotë të personelit akademik dhe kanë së paku gradën shkencore "Doktor".
2. Numri i zëvendësdekanëve, emërimi dhe shkarkimi i tyre përcaktohet nga vetë Dekani me vendim sipas nevojave të njësisë kryesore. Numri i zëvendësdekanëve nuk mund të jetë më shumë se dy.
3. Kompetencat e zëvendësdekanëve përcatohen sipas Rregullores.

Bëhet:


**Neni 36
Zëvendësdekani**

1. Dekani, në ushtrimin e funksioneve të tij, ndihmohet nga zëvendësdekanët.
2. Zëvendësdekanët janë anëtarë me kohë të plotë të personelit akademik dhe kanë së paku gradën shkencore "Doktor".
3. Numri i zëvendësdekanëve, emërimi dhe shkarkimi i tyre përcaktohet nga vetë Dekani me vendim sipas nevojave të njësisë kryesore. Numri i zëvendësdekanëve nuk mund të jetë më shumë se dy.
4. Kompetencat e zëvendësdekanëve përcatohen në Rregulloren e Brendshme të UV-së.

- Saktësimin e nenit 38 pika 1 shtohet si mëposhte:

**Neni 38
Drejtuesi i njësisë bazë**

1. Drejtuesi i njësisë bazë është drejtuesi i departamentit ose i qendrës kërkimore-shkencore. Ai është autoriteti drejtues akademik i asaj njësie dhe e përfaqëson atë. Në institucionet publike të arsimit të lartë ai zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë bazë. Ai zgjidhet nga personeli akademik sipas përcaktimeve ligjore dhe duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
 - a) duhet të jetë personel akademik i kategorisë "Profesor" ose të ketë gradën shkencore "Doktor" PhD të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të BE-së ose të OECD-së;
 - b) duhet të ketë përvojë në mësimdhënie për një periudhë jo më pak se 5 vjet dhe të jetë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë;
 - c) të ketë veprimtari të spikatur akademike, kërkimore e shkencore të vazhdueshme
 - d) të mos jetë dënuar me një vendim të formës së prerë për vepra penale;
 - e) të mos ketë masë disiplinore në fuqi; e) të mos ketë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" dhe ligjit nr. 138/2015



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK

"Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

- **Saktësimin e nenit 40 sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë në zbatim të shkresës nr.4350/1 prot, datë 09.09.2021 si dhe rekomandimeve të MAS nr. 4506 prot, datë 15.07.2024 ku punësimet duhet të jenë në përputhje me nenin 51 të ligjit nr.80/2015 dhe pikës 16, të udhëzimit nr. 27, datë 29.12.2017.**

1. Neni 40, pika 3 shkronja e:

Ishte:

I propozon Bordit të Administrimit kriteret specifike të punësimit të personelit administrativ, si dhe marrjen e masave disiplinore;

Bëhet:

Në cilësinë e punëdhënësit të personelit administrativ i propozon Bordit të Administrimit kriteret dhe procedurat e punësimit si dhe ushtron të drejtën e dhënies së masave disiplinore ndaj personelit administrativ.

Neni 40, pika 3 shkronja ë:

Ishte:

Propozon komisionin *ad-hoc* për konkursin e rekrutimit të personelit administrativ, sipas përcaktimeve në këtë Statut;

Bëhet:

Urdhëron ngritjen e komisionit *ad-hoc* për konkursin e rekrutimit të personelit administrativ, sipas përcaktimeve në këtë Statut;

2. Në nenin 40 pika 3 të shtohen si vijon:

- **gërma h)** Pas përfundimit të afateve ligjore emëron dhe nënshkruan kontratën e punës me personelin administrativ të UV- së.
- **gërma i)** Urdhëron largimin nga detyra dhe zgjidhjen e menjëhershme të marrdhënies së punës me personelin administrativ të UV-së sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

- **Shtimin e nenit Neni 44 Personeli akademik, pika 4, 5, 6, 7**



Ishte:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK



Neni 44

Personeli akademik

1. Personeli akademik në UV kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të UV-së, këshillim për studentët, konsulencë e trajnime për të tretët, si dhe veprimtari të tjera.

1. Personeli akademik në UV është me orientim mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor. Njësitë bazë dhe kryesore kanë detyrimin që të bëjnë këtë klasifikim për UV-në dhe ta rinovojnë atë në mënyrë periodike.

2. Personeli akademik në UV, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në:

- a) profesorë;
- b) lektorë;
- c) asistent-lektorë.

3. Në kategorinë "Profesorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë "Profesor" ose "Profesor i asociuar".

Bëhet

Neni 44

Personeli akademik

1. Personeli akademik në UV kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të UV-së, këshillim për studentët, konsulencë e trajnime për të tretët, si dhe veprimtari të tjera.

2. Personeli akademik në UV është me orientim mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor. Njësitë bazë dhe kryesore kanë detyrimin që të bëjnë këtë klasifikim për UV-në dhe ta rinovojnë atë në mënyrë periodike.

3. Personeli akademik në UV, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në:

- d) profesorë;
- e) lektorë;
- f) asistent-lektorë.

4. Në kategorinë "Profesorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë "Profesor" ose "Profesor i asociuar". Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.

5. Në kategorinë "Lektorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik, që zhvillojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore. Në këtë kategori përfshihen anëtarët e personelit akademik, që mbajnë gradën shkencore "Doktor", kanë së paku tre vite eksperiencë në mësimdhënie para ose pas fitimit të kësaj grade shkencore. Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.

6. Në kategorinë "Asistent-lektorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore-kërkimore. Asistent-lektorët duhet të kenë së paku diplomën "Master i shkencave". Asistent-lektori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të caktuar.

7. Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Ngarkesa e plotë mësimore për personelin akademik përcaktohet nga



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK

strukturat përgjegjëse në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin.

- **Saktësim të pikës 9, të nenit 45 duke patur parasysh që udhëzimet mund të ndryshohen herë pas here është propozuar që most ë shprehen në numra dhe shifra orët e punës dhe lejes.**

Ishte:

9. Koha normale e punës së personelit akademik nuk mund të jetë më shumë se 1 536 orë në vit. Ngarkesa mësimore e personelit akademik parashikohet në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin.

10. Leja vjetore e personelit akademik është jo më pak se 40 ditë pune (56 ditë kalendarike). Në rast se kjo leje nuk konsumohet nga personeli akademik, si pasojë e nevojës së institucionit dhe me propozimin e përgjegjësit të njësisë bazë dhe me miratimin e Bordit të Administrimit, jepet shpërblimi përkatës në të holla.

13. Personeli akademik mund të kryejë detyra të larta në administratën publike, vendase apo të huaj, për jo më shumë se 5 vjet, pa ndërprerje, duke ruajtur statusin e tij. Në funksion të ruajtjes së vendit të punës, sipas profilit akademik, nënshkruhet një marrëveshje e posaçme me rektorin e UV-së. Pas kësaj periudhe, anëtari i personelit akademik, me kërkesën e tij, rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend të barasvlefshëm.

Bëhet:

9. Koha normale e punës së personelit akademik si dhe ngarkesa mësimore parashikohet në përputhje me aktet nenligjore ose udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin.

10. Leja vjetore e personelit akademik përcaktohet në aktet nenligjore ose udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Në rast se kjo leje nuk konsumohet nga personeli akademik, si pasojë e nevojës së institucionit dhe me propozimin e përgjegjësit të njësisë bazë dhe me miratimin e Bordit të Administrimit, jepet shpërblimi përkatës në të holla.

13. Personeli akademik mund të kryejë detyra të larta në administratën publike, vendase apo të huaj, për jo më shumë se 5 vjet, pa ndërprerje, duke ruajtur statusin e tij. Në funksion të ruajtjes së vendit të punës, sipas profilit akademik, nënshkruhet një marrëveshje e posaçme me rektorin e UV-së. Pas kësaj periudhe, anëtari i personelit akademik, me kërkesën e tij, rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend të barasvlefshëm. Në rastet kur detyra në administratën publike ka zgjatur më shumë se 5(pesë) vjet pa ndërprerje, personeli akademik e humb statusin e tij.

- **Ndryshim Neni per vitin sabatik**

Ishte:

Neni 48

Viti akademik sabatik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI JURIDIK

1. Personeli akademik i kategorisë "Lektor" dhe "Profesor", me miratim të njësisë bazë ku zhvillon veprimtarinë akademike, ka të drejtë të shkëputet nga angazhimet e institucionit, një herë në shtatë vjet, për periudha kohe deri në një vit, për të punuar për përparimin e tij akademik.
2. Midis personelit akademik dhe rektorit të Universitetit "Ismail Qemali" nënshkruhet një kontratë ku rregullohen kohëzgjatja, të drejtat dhe detyrimet, si dhe efektet financiare.
3. Gjatë kësaj periudhe, personelit akademik nuk i ngarkohet detyrë mësimdhënieje.
4. Personeli akademik mund të ndjekë gjatë këtij viti kurse specializimi jashtë institucionit.

Bëhet:

Neni 47

Viti akademik sabatik

1. Personeli akademik i kategorisë "Lektor" dhe "Profesor", me miratim të njësisë bazë ku zhvillon veprimtarinë akademike, ka të drejtë të shkëputet nga angazhimet e institucionit, një herë në shtatë vjet, për periudha kohe deri në një vit, për të punuar për përparimin e tij akademik.
2. Për të përfituar nga parashikimi i pikës 1, anëtari personelit akademik duhet të paraqesë në departament kërkesën e tij të shoqëruar me propozimin përkatës për kërkimin shkencor që do të realizojë, vendin ku do ta ushtrojë këtë kërkim, nëse ka, kohën e nevojshme që i duhet, si edhe produktin që do të dorëzojë në fund të kësaj periudhe. Departamenti shpreh miratimin e tij dhe njofton drejtuesin e njësisë kryesore dhe Rektorin e UT-së.
3. Nëse kërkohet edhe mbështetje financiare në përputhje me zërat buxhetorë të miratuar nga Bordi i Administrimit për këtë qëllim, propozimi i kalon edhe Bordit të Administrimit për miratimin e pjesës financiare.
4. Kërkesa, në çdo rast duhet që të paraqitet dy muaj përpara fillimit të vitit akademik sabatik.
5. Gjatë vitit akademik sabatik, anëtari i personelit akademik paguhet me 100 për qind të pagës.
6. Midis personelit akademik dhe rektorit të Universitetit "Ismail Qemali" nënshkruhet një kontratë ku rregullohen kohëzgjatja, të drejtat dhe detyrimet, si dhe efektet financiare.
7. Gjatë kësaj periudhe, personelit akademik nuk i ngarkohet detyrë mësimdhënieje.
8. Personeli akademik mund të ndjekë gjatë këtij viti kurse specializimi jashtë institucionit.
9. Mosrealizimi i kërkimit shkencor, sipas programit të miratuar, përbën shkak për përgjegjësi disiplinore, si dhe detyron të rimbursojë të gjitha përfimet financiare që ka marrë.
10. Mënyra e kontrollit të cilësisë së produktit që duhet të realizohet gjatë vitit sabatik, bëhet në përputhje me parashikimet e rregullores së njësisë kryesore, sipas marrëveshjes së nënshkruar.

- **Neni 49 Personeli ndihmësakademik ishte:**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK

Personeli ndihmësakademik në UV ndahet në personel ndihmësakademik me karakter mësimor dhe ndihmësakademik me karakter administrativ.

1. Strukturat ndihmësakademike me karakter administrative në nivel institucioni janë:

- a) Strukturat e kurrikulave;
- b) Strukturat e kërkimit shkencor;
- c) Strukturat e projekteve;
- ç) Strukturat e promovimit akademik dhe botimeve;
- d) Strukturat e marrëdhënieve me publikun;
- dh) Strukturat e marrëdhënieve me jashtë;
- e) Strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë;
- ë) Strukturat e karrierës;
- f) Strukturat e bibliotekave;
- g) Strukturat juridike;
- gj) Strukturat e teknologjisë së informacionit;
- h) Strukturat e burimeve njerëzore;
- i) Strukturat e arkiv-protokollit;
- j) Asistent i rektorit.

2. Strukturat ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel njësie kryesore janë:

- a) Sekretaritë mësimore të njësive kryesore;
- b) Asistent i dekanit.

3. Strukturat ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel njësie bazë janë:

- a) Sekretaritë në Departamentet e Drejtësisë dhe Gjuhëve të Huaja (pasi përmbushin kriterin e pikës 10 të udhëzimit nr 27, datë 29.12.2017).

4. Personeli i strukturave sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni janë personel ndihmësakademik me karakter administrativ në kuptim të pikës 3 të nenit 66 të ligjit 80/2015.

5. Strukturat ndihmësakademike me karakter mësimor në nivel njësie kryesore dhe bazë janë:

- b) laborantët;
- c) specialistët e QKSH-ve.

6. Personeli i strukturave sipas pikës 5 të këtij neni konsiderohen personel ndihmës akademik me karakter mësimor në kuptim të pikës 2 të nenit 66 të ligjit 80/2015.


Bëhet:

Neni 48

Personeli ndihmësakademik

1. Personeli ndihmësakademik në UV ndahet në personel ndihmësakademik me karakter mësimor dhe ndihmësakademik me karakter administrativ.

2. Personeli ndihmësakademik me karakter mësimor është pjesë e njësisë bazë. Ai ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor. Në këtë kategori futen laborantët, teknikët si dhe personel tjetër, sipas



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK



përcaktimeve të bëra në aktet ligjore e nënligjore. Struktura përcaktohet në rregulloren e institucionit.

3. Personeli ndihmës akademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbësh-tetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe /ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel institucional. Në këtë kategori bëjnë pjesë personeli i përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore. Struktura përcaktohet në rregulloren e institucionit.


- **Nenet që flasin për kategoritë e personelit kanë ndryshur duke u vendosur sipas renditjes që ka ligji si dhe duke shtuar procedurat e punësimit të cilat mungonin, në zbatim të neneve përkatëse për ligjin për arsimin e lartë.**
- **Në neni 56 pika 3 është bashkuar me pikën 2.**
- **Është shtuar neni:**

Neni 66 (nen i ri)

Programet e studimit në fushën e mësuesisë dhe drejtësisë

1. Programet e studimit në fushën e mësuesisë për arsim parashkollor dhe arsim fillor, organizohen në dy cikle: program i ciklit të parë "Bachelor", që formon mësues të arsimit parashkollor dhe program i ciklit të dytë "Master profesional", që formon mësues të arsimit fillor.
 2. Programet e studimit për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", me 120 kredite, sipas fushave përkatëse të forrnimit.
 3. Programet e ciklit të dytë të studimit në fushën e mësuesisë duhet të përmbajnë 25 % të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik.
 4. Programet e ciklit të dytë të studimit, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 % të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.
- Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë të studimeve në fushën e drejtësisë realizohen me 300 kredite, për një kohëzgjatje prej jo më pak se 5 vite akademike.

- **Neni Transferimi i studimeve, njohja dhe njësimi i periudhave të studimit është shtuar pika 4**
- **Shtesë në pikën 3 të nenit Të drejtat dhe detyrimet e studentëve**
- **Shtesë në pikën 5 të nenit Këshillat e studentëve:** Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucioneve të arsimit të lartë, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK

bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.

Sa më sipër propozojmë që ky material t'i përcillet për miratim paraprak Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik të UV-së në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PËRGJEGJËS SEKTORI
Gentjana BELULAJ